

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Наставна програма
АЛБАНСКИ ЈАЗИК (ЈАЗИК НА ЗАЕДНИЦАТА)
за VIII одделение

Programi mësimor
GJUHË SHQIPE (GJUHË E BASHKËSIVE)
për klasën VIII

Скопје/Shkup, 2025

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	Lëndë me zgjedhje
Klasa	VIII (e tetë)
Temat/fushat programore	• Përditshmëria ime në mjedisin ku mësoj, ku jetoj dhe ku shoqërohem • Në rrethinën e afërt • Komunikimet, lidhjet dhe njohja e ngjashmërive dhe dallimeve
Numri i orëve	2 orë në javë / 72 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	• Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, dërrasë e zezë, teknologji kompjuterike, printer. • Mjetet dhe burimet mësimore: foto, fotografi, postera, postera nga libra, skema dhe paraqitje të materialit mësimor, tabela që përcjellin materialin mësimor sipas fushave; fjalorë, fjalorë drejtshkrimi, leksikon, enciklopedi, libra, programe kompjuterike edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; • Biblioteka me libra në klasë, biblioteka e shkollës..
Normativi për kuadrin mësimor	Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe (gjuhë e bashkësive) në klasën VIII (e tetë) të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore: • Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <i>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike.</i>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit që përmenden në Programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën

Përdorimi i gjuhëve të tjera – Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
II-A.1	të kuptojë fjalitë dhe frazat që përdoren shpesh dhe që kanë të bëjnë me fusha të afërta me rëndësi personale (të tilla, si informacione personale dhe familjare, nevoja dhe interesa të ndryshme);
II-A.2	të nxjerrë porosinë kryesore nga mesazhet e thjeshta e të qarta, nga njoftimet, nga udhëzimet nga lutjet etj.
II-A.3	të lexojë dhe të kuptojë tekste të thjeshta të llojeve të ndryshme, për tema të njohura dhe më pak të njohura, të përshtatshme për moshën;
II-A.4	të gjejë informacione konkrete në tekste reale të ndryshme (p.sh. në reklama, në plane, në udhëzime, në broshura, në lista ushqimesh, në orare udhëtimesh etj.) dhe të kuptojë mesazhe të shkurtra të thjeshta, për të menaxhuar situatat e përditshme;
II-A.5	të komunikojë në situata të përditshme konkrete kur kërkohet një shkëmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë informacioni për tema të njohura;
II-A.6	të shqiptojë qartë dhe saktë të gjithë tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksit dhe intonacionit, ndërkohë që parregullsitë e mundshme të mos e pengojnë komunikimin;
II-A.7	të përdorë shprehje të zakonshme dhe fjali që përdoren gjatë përvojës së drejtpërdrejtë dhe/ose u referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.8	të shkruajë fjalë dhe shprehje me saktësi relative, duke zbatuar rregullat e drejtshkrimit;
II-A.9	të respektojë rregullat themelore të gramatikës gjatë të shprehurit me shkrim dhe me gojë;
II-A.10	të shprehë dhe të argumentojë ndjenjat dhe mendimet në lidhje me çështjet me interes të drejtpërdrejtë;
II-A.11	të përdorë varg deklaratash dhe fjalish për të shkruar një mesazh, një letër, një shënim, një kartolinë dhe të përshkruajë me fjalë të thjeshta gjërat me interes të drejtpërdrejtë;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
II-B.1	të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtëson mësimin e shumë gjuhëve dhe mundësinë e komunikimit me anëtarë të grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore;
II-B.2	njohja e më shumë gjuhëve lehtëson qasjen në burime që janë të dobishme për përvetësimin e lëndëve/përmbajtjeve të tjera mësimore;
II-B.3	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe respekti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme;
II-B.4	përmes të mësuarit të gjuhëve të tjera zhvillohet respekti për kulturat e tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të fushave të Standardeve nacionale, siç janë: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike dhe Të shprehurit artistik dhe kultura.**

IV. Njohuri digjitale

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe të krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë apo për një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe instalojë programe që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidhë probleme rutinë në funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve të ndryshme digjitale;
IV-A.3	të përdorin mënyra të ndryshme për të organizuar, për të ruajtur dhe për të ndarë në mënyrë të sigurt përmbajtjet në pajisje dhe rrjete të ndryshme në hapësirën digjitale;
IV-A.4	në bashkëpunim me të tjerët të analizojë një problem, të zhvillojë ide dhe plane për hulumtimin dhe për zgjidhjen e tij dhe të planifikojë kur dhe për çfarë të përdoret TIK-u;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë lidhjen e tyre me nevojën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.6	të zgjedhë dhe të përdorë vegla të ndryshme për përpunimin e të dhënave, të analizojë të dhënat dhe t'i paraqesë ato në mënyra të ndryshme duke respektuar rregullat e përdorimit;
IV-A.7	të zgjedhë dhe të përdorë mjetet e duhura të TIK-ut për komunikim, të ndajë në mënyrë të sigurt informacionin, të kontaktojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën digjitale multikulturore;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
IV-A.11	të planifikojë dhe zhvillojë pjesë udhëzimesh të qarta për kryerjen e një detyre specifike dhe t'i paraqesë ato si një algoritëm programimi;
IV-A.12	të hulumtojë mundësitë për përdorimin e modeleve dhe simulimeve të ndryshme, duke kombinuar paraqitje statike dhe dinamike, zë, tekst dhe imazhe për të modifikuar ose krijuar produkte të thjeshta multimediale me një qëllim të caktuar dhe për një audiencë specifike;
IV-A.13	të përcaktojë kriteret e cilësisë për produktet dhe zgjidhjet digjitale duke përfshirë inovacionin dhe dobinë prej tij.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	

IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.2	përdorimi i papërgjegjshëm dhe jo i duhur i TIK-ut ka kufizime dhe mund të sjellë rreziqe për individin ose për shoqërinë;
IV-B.3	potencialet e TIK-ut do të rriten prandaj duhet të ndiqen dhe përdoren duke pasur qasje kritike ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digjitale;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, privatësisë dhe sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes dhe dhuna kibernetike dhe të respektohen rregullat dhe normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacioni i disponueshëm në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;
IV-B.6	duhet të respektohen të drejtat e pronësisë intelektuale të produkteve të disponueshme në rrjetet digjitale;
IV-B.7	pozita jo e duhur e trupit dhe përdorimi i pamasë i teknologjive digjitale mund të ndikojë negativisht në shëndetin, jetën personale dhe sociale dhe ruajtja jopërkatese e hedhurinave digjitale ndikon në mënyrë të pavolitshme në mjedisin jetësor.

V. Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
V-A.1	të dallojë mënyrën e shëndetshme të jetesës nga ajo e rrezikshmja në të gjitha sferat e jetës (duke përfshirë zakonet e të ngrënit, aktivitetet sportive dhe rekreative dhe sjelljen seksuale);
V-A.2	të zgjedhë dhe të praktikojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij mendore dhe fizike;
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë ndaj identitetit të ndryshëm shoqëror (p.sh. gjinia, identiteti etnik dhe kombëtar) dhe rolet e ndryshme që ka në jetë (p.sh. nxënës/e, djalë/vajzë);
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij /asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet e vetvetja dhe të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mësimi e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);

V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, me vetëdije të plotë se kujt, kur dhe si të kërkohet ndihmë.
V-A.12	të përballojë me sukses presionet sociale;
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.16	të njohë problemet në marrëdhëniet me të tjerët dhe t'i qaset në mënyrë konstruktive zgjidhjes së konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (kthyes) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.18	të hulumtojë, të bëjë pyetje përkatëse, për të zbuluar probleme, për të analizuar dhe vlerësuar informacionin dhe propozimet dhe për të kontrolluar supozimet;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.20	të analizojë në mënyrë kritike informacionin dhe dëshmitë sipas kriterëve përkatëse;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënët.
<i>Nxënësi/nxënësjë kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.1	kujdesi për trupin dhe praktikimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për të siguruar shëndet të mirë fizik dhe mendor;
V-B.2	njohja e identitetit personal kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit;
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.5	zgjidhja e problemeve dhe konflikteve, varet nga mënyra se si i qaset zgjidhjes së problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve;
V-B.6	suksesi në jetë, në një masë të madhe, varet nga qëllimet që ai i vendos vetes , ndërsa efikasiteti dhe efektiviteti në arritjen e qëllimeve të vendosura në masë të madhe varet nga mënyra se si ai i planifikon aktivitetet dhe organizon kohën e tij;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese (kthyes) dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.
V-B.10	të mësuarit është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

VI. Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi/nxënësjka di dhe mund:</i>	
VI-A.1	të shpjegojë se si faktorët socialë ndikojnë në personalitetin e njeriut dhe në mjedisin jetësor dhe t'i marrin ato parasysh gjatë formimit të opinioneve dhe marrjes së vendimeve;
VI-A.2	të analizojë sjelljen e vet me qëllim të përmirësimit, duke vendosur synime reale dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet;
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij, të dëgjojë dhe të analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt edhe kur nuk është dakord me to;
VI-A.4	të reflektojë në mënyrë kritike për vlerat dhe sjelljet e ndryshme personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (veçanërisht në situata të ndjeshme etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranuar nga shoqëria, por edhe t'i sfidojë ato kur mendon se është e nevojshme;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve te vetja e te të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël), në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
	të identifikojë dhe t'i rishqyrtojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që manifestohen në mjedisin e tij/saj;
VI-A.19	të shpjegojë rëndësinë e proceseve demokratike në shoqëri dhe të zbatojë parimet e pjesëmarrjes demokratike në kuadër të shkollës.
<i>Nxënësi/nxënësjka kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.1	nuk duhet të diskriminojë në bazë të dallimeve ndërmjet njerëzve (gjinia dhe përkatësia etnike, moshë, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.)
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre;
VI-B.3	të drejtat e njeriut janë universale dhe kufijtë e të drejtave të çdo personi janë të drejtat dhe liritë e të tjerëve;
VI-B.4	respektimi pa dallim i të drejtave dhe lirive të njeriut është thelbësor për mirëqenien e individëve dhe shoqërisë në tërësi;
VI-B.5	barazia, e drejta dhe kohezioni social janë thelbësore për funksionimin e suksesshëm të komunitetit;
VI-B.6	angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishëm për arritjen e interesit të përbashkët publik;

VI-B.7	çdo qytetar është i detyruar të sillet me përgjegjësi ndaj bashkëqytetarëve të tij, ndaj komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, duke pasur parasysh vazhdimisht pasojat e veprimeve të tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit;
VI-B.12	vendi ynë është një shoqëri multikulturore/multietnike në të cilën jetojnë anëtarë të kulturave/etnive të ndryshme dhe secili qytetar të saj është përgjegjës për të kontribuar në shkëmbimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në interes të të jetuarit së bashku në një shoqëri të integruar dhe etnikisht koheze;

VIII. Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike;
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e afërt dhe atë të gjerë dhe të analizojë ndërlidhjen dhe varësinë reciproke të tyre;
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
VIII-B.4	diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme;
VIII-B.5	dallimet ndërmjet kulturave duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si sfidë për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë;
VIII-B.6	respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit të kulturës së vet nga të tjerët.

REZULTATET E TË NXËNIT

Tema: Përditshmëria ime në mjedisin ku mësoj, ku jetoj dhe ku shoqërohem

Gjithsej: 28 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësjë do të jetë i/e aftë:

1. të zhvillojë një bisedë në situata të ndryshme që përfshijnë informacione për veten e tij/saj si adoleshent, shkollën dhe miqtë në të, obligimet në shkollë, marrëdhëniet familjare dhe fqinjësore, përfshirjen e aktiviteteve vullnetare;
2. të parashtrojë pyetje dhe t'u përgjigjet pyetjeve me njësi leksikore karakteristike për temat që diskutohen;
3. të ndërtojë fjali, të thjeshta dhe të përbëra, duke përdorur fjalët e njohura në formën e duhur gramatikore;
4. të lexojë dhe të kuptojë dialogë, tekste të shkurtra dhe paragrafë që flasin për komunikimet e përditshme;
5. të shkruajë një tekst të shkurtër në të cilin i përdor strukturat përkatëse gramatikore: emrat, mbiemrat dhe përemrat në gjininë dhe në numrin përkatës, foljet në kohën e duhur: kohën e tashme, kohën e kryer, e ardhmja e së shkuarës dhe format e pashtjelluara të foljes.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)

a) Modelet e komunikimit

- **Vitet e mia të adoleshencës**

Unë dhe prindërit e mi

Më pëlqen të vishem me...

Më pëlqen të vesh (vishem)...

Unë kujdesem për pamjen time.

Unë përdor kozmetikë të ndryshëm për fytyrën dhe trupin.

Grupi/këngëtari im i preferuar është...

Defokusohem nga gjërat që...

Më vjen turp kur...

Ndihem i/e dashur/refuzuar sepse...

Unë shoqërohem me...

Festa (Party) e shkollës...

- **Shkolla - vendi ku krijohen miqësi të reja**

Shkolla - vend ku krijohen miqësi të përjetshme.

Njoh miq nga bashkësitë e ndryshme etnike.

Standardet për vlerësim:

- Shqipton dhe shkruan drejt fjalët dhe i përdor në kontekste adekuate gjuhësore.
- Formon ndërgjegjësimin për veten dhe njerëzit që e rrethojnë dhe e shpreh atë me fjalë dhe fjali adekuate.
- I dallon gjërat që i pëlqejnë, prirjet, aftësitë dhe shkathtësitë e tij.
- Përdor shprehje adekuate për të përshkruar ndjenjat e tij.
- Flet për ngjarjet në të cilat ka marrë pjesë.
- Përdor thënie në të cilat përshkruan tiparet e karakterit të shokëve/shoqeve të tij/saj dhe flet për miqësinë.
- Shpjegon për diversitetin (fetar, gjinor, etnik), duke e bazuar qëndrimin e vet nëpërmjet shoqërimit me ata që janë të ndryshëm nga ai/ajo.
- Jep shembuj që e tregojnë shkollën si vend ku zhvillohet një klimë pozitive respekti dhe mirëkuptimi.
- Zhvillon dialog (bisedë) për rëndësinë e miqësisë dhe të empatisë, duke përdorur leksikun e duhur.
- Përdor shprehje në të cilat i tregon aktivitetet e punës në shkollë.

Projektet shkollore dhe aktivitetet ekipore - mundësi për shoqërimi dhe njohje të reja.
Shkolla na hap dyer dhe horizonte të reja.
Shkolla nuk është vetëm një vend për të fituar njohuri, shkolla është gjithashtu një vend për të krijuar miqësi të reja. Miqtë e mi nga shkolla.
Mbështetja e miqve të mi nga shkolla më vlen shumë.

- **Obligimet dhe sfidat brenda dhe jashtë shkollës**
 Obligimet dhe sfidat e mia të përditshme në shkollë:
punoj në detyra të ndryshme, marr pjesë në përgatitjen e projekteve, marr pjesë në aktivitete dhe gara sportive, marr pjesë në ngjarje kulturore, bëj miq të rinj, ndihmoj shokët e klasës etj.

Obligimet dhe sfidat e mia të përditshme jashtë shkolle: *i përkushtohem hobit tim, merrem me sport, mësoj shqip, mësoj gjuhë të huaja, shoqërohem me miqtë dhe anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë, ndjek ndeshje sportive, ndjek ngjarje kulturore etj.*

- **Familja, fqinjët dhe shokët (marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes, fqinjëve dhe miqve)**
Takohem shpesh me shokët e mi.
Mami pi shpesh kafe te fqinja.
Familja ime është shumë e rëndësishme për mua.
Shkoj shpesh te gjyshja ime, sepse ajo jeton vetëm.
Flasim gjatë për kujtimet e saj të fëmijërisë.
Agroni është i dashuruar me Mirën. Dashuria është ndjenja më e fortë.
– Kur u njohët me Nalanin? – U njohëm vitin e kaluar.
Xhaxhai im është shakaxhi i madh. Shpesh bën shaka.
Kryetar i Këshillit të Shtëpisë është fqinji Ramiz.
Të gjithë kujdesemi për ndërtesën ku jetojmë.

- Tregon dhe shpjegon sfidat e përfshirjes në aktivitete të projekteve, gara dhe ngjarje kulturore.
- Shpjegon pikëpamjet e tij/saj për sfidat e përditshme jashtë shkolle.
- Pyet dhe u jep përgjigje pyetjeve që lidhen me marrëdhëniet me miqtë dhe anëtarët e familjes së ngushtë dhe të gjerë.
- Përfshihet në biseda në të cilat shpreh qëndrimin për hobin, aftësitë dhe shkathtësitë e tij/saj.
- Bën përmbledhje të ngjarjeve nga jeta sportive dhe kulturore.
- Përdor drejt modele gjuhësore, shprehje dhe fjali të sakta për të prezantuar fqinjët e vet.
- Përdor shprehje për të treguar respekt dhe besim të ndërsjellë për njerëzit në lagje që janë të ndryshëm nga ai/ajo (në aspektin kulturor, fetar, etnik dhe gjinor).
- Numëron aktivitetet e përbashkëta për një jetë më të mirë në lagje.
- Tregon shembujt e vet të pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e problemeve të lagjes.
- Parashtron dhe u përgjigjet pyetjeve rreth kujdesit për mjedisin ku jeton.
- Merr pjesë në dialogë në të cilët flet për obligimet e veta në lagjen ku jeton.
- Tregon ide dhe propozime për përmirësimin e jetës në komunitet.
- Propozon aktivitete për zhvillimin e komunitetit në të cilin jeton.
- Përdor shprehje të përshtatshme për të treguar pikëpamjet e tij/saj lidhur me të gjitha aksionet e organizuara në komunitetin në të cilin jeton.
- Prezanton vlerat pozitive nga të cilat përfiton komuniteti në të cilin jeton.

<i>Në mbledhjen e fundit, banorët e moshuar ranë dakord të rregullojnë parkun para ndërtesës.</i> • Kontributi im në komunitetin ku jetoj <i>Marr pjesë aktive me ide dhe propozime për të përmirësuar jetën në komunitet.</i> <i>Marr pjesë në aktivitete zhvillimore në komunitetin ku jetoj.</i> <i>Kontribuoj në ngjarjet kulturore dhe në manifestimet sportive që zhvillohen në komunitetin tim.</i> <i>Marr pjesë në aksionet ekologjike të organizuara në komunitetin tim.</i> <i>Promovoj vlera pozitive nga të cilat përfiton komuniteti në të cilin jetoj.</i>	
b) Njësitë leksikore • Emrat: fazë/a, rini, moshë, fëmijëri, periudhë, themel, djalë, vajzë, person, hapësirë, vlerë, liri, aftësi, prirje, argëtim, projekt, ngjarje, horizont, komunitet, aksion, produkte, kafshë të përkëdhelura... • Mbiemrat: i/e pavarur, i/e vendosur, i/e shqetësuar, i/e hutuar, i padurueshëm/ e padurueshme, i/e zhytur në mendime, i/e emocionuar... • Foljet: zhvilloj/zhvillohem, formoj/formohem, di/dihet, tentoj/tentohet, përqendroj/përqendrohem, bëj, dua, jap, marr, afro, njoh, zbuloj, vizitoj, ndihmoj, kujdesem... • Ndajfoljet: andej, kënde, diku, askund, kudo, atëherë, ndonjëherë, asnjëherë, fort, dobët, miqësisht, mjerueshëm, tërësisht, gëzueshëm, hareshëm... • Lidhëzat: por, mirëpo, as, jo vetëm që....por edhe...	• Riprodhon dhe përdor emrat e sapomësuar dhe jep shembuj. • Emërton gjërat që i pëlqejnë, që i do dhe që i përdor. • Emërton dhe numëron gjërat që shkaktojnë ndjenja të ndryshme tek adoleshentët. • Emërton dhe numëron aktivitetet e punës në shkollë. • Tregon aktivitetet më të rëndësishme për të përmirësuar jetën në komunitet, duke përdorur emra dhe mbiemra të përshtatshëm. • Ndërton fjali të përbërë duke përdorur folje në kohën e kryer dhe në të ardhmen e së shkuarës. • Ndërton fjali të përbërë duke përdorur ndajfolje, parafjalë/lokucione parafjalore, lidhëza dhe fjalë e togje të fjalëve të ndërmjetme adekuate.

• Parafjalët dhe lokucionet parafjalore: për, prapa, nga, rreth, nëpërmjet, për shkak, për arsye... • Fjalë dhe togjet e fjalëve të ndërmjetme: me siguri, për fat të mirë, ndoshta, sidomos, për fat të mirë, për fat të keq, për habi...	
c) Gramatika • Fonetika dhe drejtshqiptimi Ndërrimet fonetike: ndikimi i tingujve mbi njëri-tjetrin, zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve Theksi në gjuhën standarde shqipe (rrokje e theksuar, shenja e theksit, theksi fundor, parafundor dhe tejfundor, theksi në fjalët e huaja) • Morfologjia dhe morfosintaksa Emrat Funksioni i emrave në fjali Mbiemrat Shkallët e mbiemrave Foljet Trajtat (diatezat), format e pashtjelluara të foljes (pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja), foljet vetore dhe pavetore Koha e kryer dhe koha e ardhme e së shkuarës • Sintaksa Fjalja e përbërë Fjalitë e përbëra me bashkërenditje Mjetet e lidhjes në fjalitë e përbëra me bashkërenditje	• Njeh dhe shpjegon ndërrimet fonetike, zëshmimin dhe shurdhimin e tingujve. • Përdor drejt fjalët ku ndodh zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve. • Njeh dhe dallon rrokjen e theksuar në fjalët. • Tregon dhe jep shembuj të fjalëve me theks fundor, parafundor, tejfundor dhe shembuj të theksimit të fjalëve me prejardhje të huaj. • Shqipton drejt fjalë me theks fundor, parafundor dhe tejfundor. • Tregon shembuj nga komunikimi i përditshëm të emrave që hyjnë në marrëdhënie të ndryshme me pjesë të tjera të ligjëratës në fjali. • Dallon shkallën krahasore dhe sipërore të mbiemrat. • Dallon dhe jep shembuj me mbiemra të përdorur në shkallë të ndryshme. • Njeh diatezat e foljes dhe foljet vetore e pavetore në një tekst. • Krahason format e pashtjelluara të foljes dhe jep shembuj me to (me pjesoren, paskajoren dhe përcjelloren). • Njeh folje në kohën e kryer dhe në të ardhmen e së shkuarës në një shprehje, në fjali dhe në një tekst të shkurtër. • Përdor trajtat e kohës së kryer në një kontekst përkatës. • Dallon dhe krahason llojet e fjalive. • Njeh dhe jep shembuj të fjalisë së përbërë. • Krahason thënie të shprehura me fjali të thjeshtë dhe me fjali të përbërë. • Përdor drejt fjalitë e përbëra me bashkërenditje.
ç) Të lexuarit dhe të shkruarit	• Lexon me shqiptim të duhur të tingujve, me theksim të saktë të fjalëve dhe me intonacion të saktë.

• Dëgjimi dhe leximi me të kuptuar i teksteve me leksik të përshtatshëm, dialogë dhe fjali me strukturë gramatikore komplekse - lidhur me temën • Dëgjimi dhe leximi me të kuptuar i teksteve me leksik të përshtatshëm, dialogë dhe fjali me strukturë gramatikore komplekse • Dëgjimi dhe leximi me të kuptuar i fjalëve, dialogëve dhe teksteve të reja • Dëgjimi dhe leximi, përgjigjet e pyetjeve që lidhen me dialogët dhe tekstet • Nxjerrja e përfundimeve nga tekstet dhe të shkruarit e qartë • Të shkruarit e tekstit duke përdorur fjalë dhe shprehje që janë të sakta nga ana gramatikore dhe semantike • Të shkruarit (në mënyrë të pavarur ose me diktim duke i zbatuar rregullat drejtshkrimore)	• Nxjerr fjalët e panjohura në tekst. • Pyet në lidhje me tekstin dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit. • Lexon dhe komenton atë që ka lexuar, në mënyrë të pavarur dhe sipas pyetjeve udhëzuese. • Shkruan tekst sipas udhëzimeve dhe pyetjeve të dhëna. • Vazhdon një tekst të filluar. • Tregon një histori duke përdorur trajtat foljore të kohës së kryer. • Përshkruan duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit me shkrim.
d) Tema për diskutim • Jam vullnetar dhe kujdesem <i>Jam vullnetar në Kryqin e Kuq dhe marr pjesë në aksione humanitare.</i> <i>I vizitoj të moshuarit dhe i ndihmoj: shkoj në treg, lexoj gazeta, sjell ushqime të shtëpisë.</i> <i>Shkoj për të blerë ilaçe dhe produkte të tjera të nevojshme për të moshuarit dhe të sëmurët.</i>	• Komenton çështjen e vullnetarizmit si një aktivitet humanitar. • Arsyeton se si i ndihmon të moshuarit, nxënësit e familjeve të rrezikuara sociale dhe kafshët e përkëdhelura të braktisura. • Nxit ose përfshihet në bisedë lidhur me secilën tërësi tematiko-komunikuese. • Interpretin përmbajtjen e tekstit të dëgjuar ose të lexuar. • Pyet për tekstin dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit. • Krahason pohime të strukturuar në një fjali të thjeshtë dhe/ose të përbërë.

*Përpiqem të ndihmoj nxënësit e familjeve të rrezikuara sociale.
Kujdesem për të strehuar kafshët e përkëdhelura të braktisura.*

Shembuj të aktiviteteve:

(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)

- Nxënësit punojnë në çifte. Secilit çift i jepet për detyrë të vendosë veten në rolin e prindërve të vet dhe të imagjinojë një pamje të jetës së përditshme të familjes. Mësimdhënësi/ja drejton imagjinatën e nxënësve, duke i ndihmuar ata të evokojnë imazhe të shtëpisë dhe të konflikteve me prindërit e tyre, kur u thonë se si të vishen apo si të sillen. Nxënësit i shkruajnë imazhet e imagjinuara dhe në fund secili çift prezanton dialogun e vet.
- Nxënësit sjellin fotografi dhe ilustrime të personazheve të tyre të preferuara, grupeve të njohura muzikore apo këngëtarëve dhe tregojnë se çfarë dinë për ta. Çfarë është ajo që i tërheq për t'i zgjedhur si të veçantë, si sillen, si vishen, çfarë është ajo që do të donin të bënin si ata? I shkruajnë këto dhe pastaj krijojnë një mesazh që e ndajnë me të gjithë, duke e shpjeguar atë.
- Nxënësit punojnë në çifte dhe simulojnë komunikim në një festë (party) shkollore dhe shoqërim me miqtë e tyre, duke përdorur fjalor të përshtatshëm.
- Nxënësit ndahen në grupe, u jepen ilustrime, piktura, fotografi (secila foto tregon një situatë të ndryshme nga përditshmëria e një djalë apo vajze që po maturohet dhe shfaq emocione të ndryshme). Me materialin ilustrues u jepet edhe një fletë pune me kërkesa për çdo foto. Duhet të shkruajnë çfarë paraqitet në foto dhe ta përshkruajnë atë që është paraqitur. Secili grup prezanton punën e tij.
- Nxënësit lexojnë një tekst mbi një temë që lidhet me dhunën e bashkëmoshatarëve dhe pastaj u përgjigjen pyetjeve rreth asaj që kanë lexuar. *(Ai bëri një vepër të mirë/të keqe.....Nxënësit ishin të padrejtë ndaj... Unë do të kisha vepruar...)*
- Nëpërmjet fotove, nxënësit njohin shokun/shoqen e tyre të shkollës dhe e përshkruajnë, tregojnë tiparet e karakterit, çfarë i bën të veçantë dhe të ndryshëm nga të tjerët.
- Nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili grup i jepet detyra të bëjë një poster në të cilin do të prezantohen familjet e Agimit, të Vesnës, të Nemanjës dhe të Hatixhes. Secili grup duhet t'ua atribuojë përkatësinë fetare dhe etnike dhe të përshkruajë jetën e tyre të përditshme. Pastaj secili grup prezanton punën, dëgjon të tjerët dhe në të njëjtën kohë i percepton dallimet, por edhe gjërat e përbashkëta që janë karakteristike për të gjithë fëmijët pa dallim të përkatësisë së tij/saj: gjinore, fetare, etnike. Në fund konstatojnë se të gjithë fëmijët kanë nevojë të njëjta, luajnë lojëra të njëjta dhe argëtohen njëllot.

- Nxënësve u jepet një listë me mbiemra nga të cilët ata i zgjedhin mbiemrat, për të cilët mendojnë se u përshtaten karakterit të tyre, ndërtojnë fjali të përbëra dhe i ndajnë me nxënësin pranë vetes.
- Nxënësit shohin një ekspozitë vizatimesh të përgatitura për prezantim. Për çdo shembull të një vizatimi, ata thonë një mbiemër dhe nëse mbiemri tregon cilësi të drejtpërdrejtë, atë e ndërrojnë sipas shkallëve. Shembujt shkruhen në një fletore, duke u kushtuar vëmendje rregullave drejtshkrimore.
- Nxënësit punojnë në çifte. Ata simulojnë situata, në të cilat duhet treguar empati. Së bashku, përshkruajnë një situatë në një fletë letre. Fletët vendosen në banka ose në mur. Kur të gjithë mbarojnë, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe i lexojnë situatat e ndryshme. Pastaj nxënësit ulen në një rreth dhe mesimdhënësi/ja bisedon me ta për situatat ku do të ishte dashur të tregohet empati. Kërkon nga nxënësit të mendojnë se si mund të formulohen mesazhe për të shprehur empati dhe e prezantojnë atë që kanë shkruar.
- Nxënësit bisedojnë në çifte sipas udhëzimeve të dhëna: *punoj detyra të ndryshme, marr pjesë në hartimin e projekteve, marr pjesë në aktivitete dhe gara sportive, marr pjesë në ngjarje kulturore, bëj miq të rinj, ndihmoj shokët e klasës.*
- Nxënësit lexojnë një tekst me karakter argëtues. Pastaj sipas përmbajtjes së tekstit dhe sipas përshkrimit të personazheve, lidhin çdo foto me imazhin që i përgjigjet. Më pas nxënësit i paraqesin përgjigjet e tyre dhe bëjnë krahasim.
- Nxënësit shkruajnë një tekst sipas udhëzimeve të dhëna që më parë: *I përkushtohem hobit tim, merrem me sport, ndjek ndeshjet sportive dhe shoqërohem me miqtë.* Më pas i lexojnë hartimet e tyre dhe së bashku diskutojnë për prirjet e tyre, përkushtimin në arritjen e synimeve të vendosura dhe ndikimin e miqve në përditshmërinë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me fjali në të cilat mungojnë foljet. Ata duhet t'i plotësojnë fjalitë me trajtat e foljeve për kohën e kryer dhe të ardhmen e së shkuarës. Secili nxënës i lexon fjalitë e plotësuara.
- Nxënësit zhvillojnë dialogë: hartojnë një dialog të shkurtër sipas fotove që u jepen, me fjali të thjeshta për të përshkruar një ngjarje që ka ndodhur në lagje. U jepen udhëzime për t'u kushtuar vëmendje obligimeve dhe pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e problemeve të lagjes, si dhe pyetje në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në kujdesin ndaj mjedisit ku jetojnë. Shembull: *Lagjja ishte plot me qese plastike. Prandaj, fqinja Vera i qortoi fëmijët. Kryetari i Këshillit të Shtëpisë caktoi një mbledhje. Ne fëmijët thamë se do të organizojmë një aksion për mbledhjen e plastikës në mjedis.*
- Nxënësit ndjekin një prezantim me fjali ku përdoren fjalë, në të cilat ndodh ndërrimi fonetik zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve. Nxënësit kanë për detyrë të gjejnë fjalë të tilla dhe më pas t'i shqiptojnë ato për të parë ndërrimin fonetik. Në një fletë pune, nxënësve u jepen një sërë fjalësh: *s'dëgjoj, mesditë, ekzistencë, absolut, e argjendte, i njëqindte* dhe ata duhet t'i fusin këto fjalë në fjalitë e dhëna ku ato nuk janë përfshirë. Më pas këto fjalë lexohen para të gjithëve.

- Nxënësit dëgjojnë një tekst në të cilin fjalët me prejardhje të huaj përdoren me theks të saktë të fjalës dhe fjalitë me intonacion të duhur të fjalisë. Secili nxënës shkruan një fjali të dëgjuar dhe e lexon me zë para gjithë klasës duke i kushtuar vëmendje intonacionit dhe theksimit të fjalëve.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla, nga katër nxënës. Secilit grup i jepet një tekst. Nxënësit kanë për detyrë t'i gjejnë foljet dhe të përcaktojnë se cilat folje u përkasin trajtave të kohës së kryer dhe cilat të pakryerës.
- Nxënësit ndahen në çifte. Çdo çift bën tabelën e vet me emrat, përemrat, mbiemrat dhe foljet. Fjalët e shkruara përdoren më pas për të ndërtuar fjali të përbëra. Në fjali nënvizojnë se kush e kryen veprimin dhe cila fjalë përfaqëson vetë veprimin dhe më pas i përcaktojnë pjesët e fjalisë së përbërë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune që ka katër kolona: e para e shënuar si kolonë në të cilën përmbahen fjalët me theks fundor: *mík, qytét, lírí, babá, shtëpí*; e dyta si kolonë në të cilën do të jenë përfshirë fjalë me theks parafundor: *mótër, aníje, déle, lúle, bésë, shkóllë*; e treta si kolonë me fjalë me theks tejfundor: *flútura, kúmbulla, plúhuri, fúshave* dhe kolona e katërt ku përfshihen fjalët me prejardhje të huaj: *kompjúter, spíker, ópera*. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit i lexojnë fjalët e të gjitha kolonave duke pasur kujdes për theksimin e saktë. Më pas fjalët i lexojnë dhe i shkruajnë në tabelë. Me ndihmën e pyetjeve nxënësit konstatojnë se ka dallim në theksimin e fjalëve: në fjalët njërrrokëshe theksi bie mbi zanoren e vetme të fjalës; në fjalët e parme theksi bie në rrënjën e fjalës (e jo në mbaresë); në fjalët e formuara me prapashtesim (përveç prapashtesave -as, -ës dhe -je), theksi vendoset në prapashtesë; në fjalët e formuara me parashtesa, theksi vendoset në rrënjë; në fjalët e përbëra (kompozita) theksi vendoset në elementin e dytë dhe në fjalët e përngjitura theksi bie në elementin e fundit formues. Pas përfundimit të aktivitetit, disa nxënës shkruajnë në tabelë nga një shembull dhe e shqiptojnë atë.
- Nxënësve u jepet një tekst. Ata i shënojnë fjalët e panjohura dhe më pas diskutojnë kuptimin e tyre. Më pas në çift shkruajnë pyetje dhe përgjigje për tekstin. Në fund, sipas pyetjeve, me disa fjali shkruajnë një përmbledhje për tekstin. Puna ndahet para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit lexojnë dy tekste të ngjashme dhe veprojnë sipas udhëzimeve. Ata shkruajnë pesë shprehje me fjalë kyçe nga të dy tekstet. Më pas jepen në tabelë dhjetë fjali nga të dy tekstet dhe duhet të përcaktojnë me S ose G cilat nga fjalitë janë të sakta ose të gabuara.
- Diskutim/bisedë: Si i keni ndihmuar të moshuarit e lagjes? (Nxënësit drejtohen të përdorin format e pashtjelluara të foljes). Shembull: *Këtë javë kam për të bërë pazar për gjyshe Verën. Dje mbeta pa punuar. Do ta ndihmoj gjysh Muharemin duke e pastruar oborrin e tij.*
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet detyrë e ndryshme: grupi i parë – *Çfarë mund të kontribuojë secili prej jush individualisht për të ndihmuar të moshuarit?* Grupi i dytë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush në lidhje me përfshirjen më të madhe në aksionet humanitare?* Grupi i tretë – *Çfarë mund të bëjë secili prej jush për një përfshirje më të madhe të nxënësve për t'u bërë vullnetarë?* Secili grup duhet të mendojë dhe të shkruajë ose të vizatojë në një fletë të madhe disa gjëra që secili prej anëtarëve të tij mund të bëjë. Më pas një nxënës nga secili grup prezanton detyrën para klasës.

- Nxënësit marrin pjesë në një diskutim në të cilin tregojnë ngjarjet kur kanë ndihmuar nxënësit e familjeve të rrezikuar sociale. Gjatë diskutimit përdorin fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra.
- Nxënësit punojnë individualisht. Ata shkruajnë fjali të përbëra me temën: *Kujdesem që kafshët e përkëdhelura të braktisura të strehohen dhe më pas lexojnë para klasës. Ata drejtohen të përdorin emra dhe mbiemra prejfoljorë: Shetitja e qenve është interesante.*

Tema: Në rrethinën e afërt

Gjithsej: 30 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të zhvillojë një bisedë në situata të ndryshme që përfshijnë mënyrë jetese të shëndetshme, mbrojtjen e natyrës, kulturën, artin dhe median;
2. të parashtrojë pyetje dhe t'u përgjigjet pyetjeve me njësi leksikore karakteristike për temat që diskutohen;
3. të hartojë fjali duke përdorur fjalët e njohura në kontekstin e duhur dhe në formën e duhur gramatikore;
4. të lexojë dhe të kuptojë dialogë, tekste të shkurtra dhe fragmente që kanë të bëjnë me komunikimet e përditshme;
5. të shkruajë një tekst të shkurtër në të cilin përdor strukturat e duhura gramatikore: emrat, mbiemrat, përemrat, ndajfoljet dhe parafjalët përkatëse, foljet në kohën, vetën dhe në numrin e duhur: kohën e kryer, të ardhmen e së shkuarës, si dhe format e pashtjelluara të foljes.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)

a) Modelet e komunikimit

- **Shëndeti – mënyra e shëndetshme e jetesës**
(natyra, ajri, i/e freskët, frymëmarrja, përdorimi, ngrënia)
*Më pëlqen të eci në natyrë dhe të thith ajër të pastër.
Ne duhet të përdorim shumë fruta dhe perime në dietën tonë.
Ushqimi i shpejtë nuk është i shëndetshëm.
Drithërat dhe produktet e qumështit janë ushqime të shëndetshme.
Nuk më pëlqen të ha byrek, sepse është shumë i yndyrshëm.*

Standardet për vlerësim:

- Shqipton dhe shkruan saktë fjalët e reja dhe i përdor në kontekste të përshtatshme gjuhësore.
- Formon ndërgjegjësimin për veten dhe njerëzit që e rrethojnë dhe e shpreh atë me fjalë dhe fjali adekuate.
- I dallon gjërat që i pëlqejnë, prirjet, aftësitë dhe shkathtësitë e tij/saj.
- Përdor shprehje të përshtatshme për të përshkruar ndjenjat e tij/saj për një mënyrë të shëndetshme jetese.
- Bën dallimin midis asaj që është e mirë dhe asaj që nuk është e mirë, në bisedë me bashkëmoshatarët; çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar.
- Përdor thënie në të cilat përshkruan tiparet e karakterit të shokëve të tij/saj dhe flet për sportin dhe aktivitetet sportive

Ne hamë shpesh oriz.

- **Sporti - njerëzit e famshëm dhe kontributi i tyre në nivel botëror**

(sporte ekipore dhe individuale, sportistë të famshëm, futboli, basketbolli, hendbolli, gjimnastika, atletika, tenisi, vrapimi, gjuajtja, koshi), goli, penalltia, pikët, reketi)

Futbolli dhe basketbolli janë sporte ekipore, kurse tenisi është sport individual.

Shoku im ushtron atletikë, ndërsa shoqja ime ushtron gjimnastikë.

Djemtë dhe vajzat e gjuajtën topin në portë.

Asaj i pëlqen të zgjohet vonë.

Blerimi zgjohet herët dhe i pëlqen të merret me sport.

Vëllai im nuk bën asgjë në shtëpi. Nuk i pëlqen as të merret me sport.

Ne fituam 3:0 në futboll. Miku im Merti vrapon aq shpejt sa Usain Bolti.

- **Natyra**

- Ekologjia, mbrojtja e natyrës, ngrohja globale**

(ekologjia, temperatura mesatare, rritet, ulet, ndotet, fëlliqet, zvogëlohet, riciklohet)

Përshkrimi i motit (mjegull, breshër, ylber, stuhi, bubullima, vetëtima, borë, akull...)

Bota bimore

Bota shtazore

Ajri, Toka, Dielli

Pemët dhe lulet janë pjesë e botës bimore. Bota shtazore në planetin tonë është e larmishme. Kishte mjegull në mëngjes dhe rrugët ishin të lagura. Dje pati një stuhi të fortë - bubullonte dhe vetëtonte. Të shtunën

- Shpjegon për diversitetin (fetar, gjinor, të përkatësisë etnike), duke e bazuar qëndrimin e vet nëpërmjet miqësisë me ata që janë të ndryshëm nga ai/ajo.
- Jep shembuj në të cilët sporti tregohet si një fushë ku zhvillohet një klimë pozitive respekti dhe mirëkuptimi.
- Zhvillon dialog (bisedë) për rëndësinë e sportit dhe lojës së ndershme, duke përdorur fjalorin e duhur.
- Përdor shprehje në të cilat përmend aktivitetet e kohës së lirë në shkollë për mbrojtjen e natyrës.
- Numëron dhe shpjegon sfidat e përfshirjes në aktivitetet e projektit, në gara dhe në ngjarjet ekologjike.
- Paraqet pikëpamjet e veta për mbrojtjen e natyrës.
- Pyet dhe u përgjigjet pyetjeve që lidhen me marrëdhëniet me natyrën, me ekologjinë dhe me ngrohjen globale.
- Përfshihet në biseda në të cilat shpreh qëndrimet për hobit, për aftësitë dhe për shkathtësitë e tij/saj.
- Bën përmbledhjen e ngjarjeve nga jeta sportive dhe kulturore.
- Përdor drejt modele gjuhësore, shprehje dhe fjali të sakta për të prezantuar fqinjët e vet.
- Përdor shprehje për të treguar respekt dhe besim të ndërsjellë për njerëzit nga kultura të ndryshme (kulturore, fetare, etnike dhe gjinore).
- Numëron aktivitetet e përbashkëta që mundësojnë një jetë më të mirë në kontekstin kulturor.
- Tregon shembujt e vet të pjesëmarrjes aktive në botën e kulturës.
- Parashtron pyetje dhe përgjigjet rreth ngjarjeve artistike në mjedisin ku jeton.
- Merr pjesë në dialogë në të cilët flet për ngjarjet kulturore dhe artistike në mjedisin e afërt.
- Jep ide dhe sugjerime për përmirësimin e jetës në komunitet.
- Propozon aktivitete për zhvillimin e komunitetit ku jeton.

ra breshër. Ylberin mund ta shohim pas shiut. Të gjithë njerëzit duhet të kujdesen për planetin Tokë. Problemi më i madh është ngrohja globale. Temperatura mesatare po rritet çdo vit. Çfarë duhet të bëjmë për ta ulur temperaturën? Kjo është çështja më e rëndësishme. Ne nuk duhet të ndotim natyrën dhe duhet të riciklojmë më shumë. Ajri, toka, lumenjtë, liqenet dhe oqeanet janë të ndotura. Shëndeti i njeriut është pasuria më e madhe. Mund të blini gjithçka, por jo shëndetin. Shkaqet e ndotjes. Shpyllëzimi (prerja e pyejeve) është një problem mbarëbotëror.

- **Kultura, arti, media**

(kultura, arti, muzeu, instrumentet, koncerti, videot, televizioni, interneti, filmi, informacioni, reklamat, ftesat...)

Kitara është instrument muzikor.

Edhe gajdja është gjithashtu instrument muzikor.

Në koncert luajti Sihana Badivuku.

Pashë një emision për Omer Faruk Tekbilekun.

I ftuar në koncert ishte Kastriot Tusha.

Shokët e mi bënë një video muzikore për shkollën tonë.

Ajo luajti së bashku me violistin e njohur Blerim Grubi.

Në shkollë shikuam një shfaqje për Nikolla Tesllën.

Një film shumë i famshëm maqedonas është "Drejtohu, Delfina", i cili i kushtohet Amina Bojaxhiu që kaloi me not La Manshin.

Adrian Gaxha është këngëtar i njohur nga Shkupi.

Ai është i njohur në mbarë Ballkanin.

Kënga e tij më e famshme është "Ngjyra e kuqe".

- Përdor shprehje të përshtatshme për të shprehur pikëpamjet e veta lidhur me të gjitha ngjarjet kulturore të organizuara në komunitetin ku jeton.
- Paraqet vlerat pozitive nga të cilat përfiton komuniteti në të cilin jeton.
- Komenton çështjen e ngjarjeve kulturore dhe artistike si një veprimtari humane.
- Nxit ose përfshihet në biseda në lidhje me secilin prej modeleve të komunikimit.
- Interpretin përmbajtjen e tekstit të dëgjuar ose të lexuar.
- Pyet për tekstin dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit.
- Krahason pohimet e strukturuar në një fjali të thjeshtë dhe/ose të përbërë.
- Emërton gjërat që i pëlqejnë, që i do dhe që i përdor.
- Emërton dhe numëron gjërat që shkaktajnë ndjenja të ndryshme tek adoleshentët.
- Emërton dhe numëron aktivitetet e punës në shkollë.
- Tregon aktivitetet më të rëndësishme për të përmirësuar jetën në komunitet, duke përdorur emra dhe mbiemra adekuatë.
- Ndërton fjali të përbërë duke përdorur folje në kohën e kryer dhe në të ardhmen e së shkuarës
- Ndërton fjali të përbërë duke përdorur drejt ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat dhe fjalët e ndërmjetme.

Prodhimi i reklamave për televizione, për faqe interneti, për banderola etj. dhe mënyra e tyre e përcjelljes së informacionit

- *Do të bëjmë një fletëpalosje për “Klubin e leximit”.*
- *Pashë një reklamë për atlete në internet.*
- *Në “Tik-Tok” kishte një lajm të rremë se Kulla e Ajfelit në Paris ishte djegur.*
- *Nuk më pëlqejnë reklamat kur shoh një serial në TV.*

Evente kulturore dhe artistike për përzgjedhjen e koncerteve, video-spoteve, filmave, muzikës më të mirë

- *Isha në koncertin e Tarkanit.*
- *Biletat për koncertin e Taylor Swiftit janë shumë të shtrenjta.*
- *Bajrush Mjaku mori çmimin për merita për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Roli i tij më i famshëm ishte ai i Dimitrija Andeeviç në filmin “Mishi i Egër”.*
- *“Ylberi” - festival muzikor për fëmijë, është ngjarje që zhvillohet në Shkup.*
- *Inva Mula është operiste me famë botërore.*
- *“Manaki” – Festivali i Filmit; mbahet në Manastir*
- *“Zgjoji” është film shqiptar i Blerta Bashollit.*
- *Çmimin për rolin më të mirë femër e fitoi Atixhja nga filmi “Toka e mjaltit”.*
- *“Teatri Shqiptar në Maqedoninë e Veriut” – Festival i Teatrit; mbahet në Dibër*
- *Çmimet “Grammy” - Ngjarje e mbajtur në Los Angeles, Kaliforni.*
- *Çmimin për këngën më të mirë e fitoi Miley Cyrus për këngën “Flowers”.*
- *Atje moda gjithmonë është në plan të parë.*
- *Performuesit veshin kostume dhe fustane nga markat e njohura të veshjeve si “Channel” e të ngjashme.*

- *Mësuesja ime e artit vizaton shumë bukur. Pashë një pikturë të saj në ekspozitë.*
- *Në orën e gjuhës shqipe do të bëjmë urime për Vitin e Ri për të gjithë mësimdhënësit.*

Blerja në qendrat tregtare (blerja, zgjedhja, ulje çmimi, shikoj, përzgjedh...)

Shkoj/ kërktoj/ blej/ shikoj/zgjedh/përzgjedh / provoj/
më pëlqen/ nuk më pëlqen/

Veshje: *çorape, kanatiere, bluzë/ pizhame, xhinse, pantallona (të shkurtra – të gjata), xhaketë, këmishë (me mëngë treçerekëshe, me mëngë të shkurtra, me mëngë të gjata), xhaketë (pranvere-vjeshte; vere, dimri)*

Këpucët: *papuçe, pantofla, atlete (sportive), këpucë (këpucë të përditshme, këpucë elegante), sandale, çizme (çizme dimri/çizme gome).*

Aksesorë të modës: *shalle, rripa, portofol (kuletë)*

Libra: *libra shkencorë, libra shkollorë.*

Kozmetikë: *shampo, balsam, grim, sapun etj.*

Elektronika: *Konsola e kompjuterit, lojërat, kompjuterët, tabletët, telefonat, kufjet (me tela dhe pa tela), bateritë, resiverët, orët inteligjente etj.*

Jam duke ecur nëpër një qendër tregtare. Do të ngjitem në katin e dytë. Aty është dyqani që kërkoj. Kërkoj një lojë të re për play Station 5.

Më duhet një telefon i ri.

Dua të blej kufje të reja.

Nesër jam në një ditëlindje dhe duhet të zgjedh një dhuratë.

Pashë një portofol (kuletë) shumë të bukur.

A keni fletore pune të gjuhës shqipe?

Po shikoj orë të reja inteligjente.

*Cilat pantallona duhet t'i provoj? – Këto... apo këto?
Do t'i provoj këto pantallona.
Do të blej një libër të ri si dhuratë.*

Objektet publike dhe shërbyese - monumente kulturore-historike, Instituti i Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore e Shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, teatri dhe kinemaja, galeria (biletë, vizitoj, shoh/shikoj, mësoj, hulumtoj, luaj, aktrim, aktroj, aktorë, skenë, film, filma të rinj, filma të vjetër, filma bardh e zi, artist, balet, shikim, luaj, rrëfim përmes lëvizjes)

- *E vizitova teatrin "Komedia". Për mua janë shumë interesante aktorët e teatrit "Komedia".*
- *Luran Ahmeti luajti në serialin e njohur turk "Sulejmani i Madhërishëm. Më pëlqeu shumë.*
- *Teuta Ajdini Jegeni është aktore e njohur shqiptare.*
- *Dje isha në Tetovë. Aty pashë kompleksin kulturo-historik "Tegenë Arabati Baba".*
- *Shtëpia përkujtimore e Nënë Terezës është një kryevepër e vërtetë.*
- *Hamami i Daut Pashës është galeri.*
- *Në galeri ka ekspozita nga artistë të ndryshëm.*
- *Muzeu i Maqedonisë është shumë i madh.*
- *QKI është qendër kulturore dhe artistike. Aty zhvillohen ngjarje të ndryshme. Zakonisht mbahen koncerte shumë të mira.*
- *Teatri antik është në Ohër. Unë isha atje në manifestimin e Verës Kulturore të Ohrit.*
- *Sa kushton bileta për të vizituar shtëpinë përkujtimore të Nënë Terezës?*

b) Njësitë leksikore

- **Emrat:** *atletikë, tenis, hendboll, basketboll, pikë, shëtitje, kulturë, kinema, teatër, art, koncert, shfaqje,*

- Riprodhon dhe përdor emrat dhe mbiemrat e sapomësuar dhe jep shembuj.
- Përdor emrat në gjininë dhe numrin e duhur.

muze, galeri, monument, instrument, kitarë, gajde, daulle, televizion, internet, film, informacion, reklama, ftesa, aktorë, balet, shikim, lojë, rrëfim përmes lëvizjes, artistë, çmim, natyrë, ekologji, mjegull, qytet, ylber, stuhi, bubullimë, shi, akull, klimë, ndryshime, kishë, xhami, sinagogë, dashuri, besim ...

- **Mbiemrat:** *i/e bukur, i/e madh, i/e vogël, i/e mirë, i/e dashur, i/e respektuar, argëtues/e, i/e mësuar, modern, i/e dobishëm/me, i/e padobishëm/me, tradicional, (i pa)njohur, i vetëm, i vetmuar, i thatë, i lagët, i saktë, i dashuruar, i freskët, i gabuar, i yndyrshëm, i kthjellët, i vrenjtur, individual, kolektiv, lojal, besnik, vendas, i huaj*
- **Numrat:** deri në 1000
- **Foljet:** *zgjedh/përzgjedh, shikoj, tregoj, them, këndoj, gjuaj, bubullin/bubullon, frymoj, përdor, mendoj, gjej, flas, luaj, veproj, ec, aktroj, kënaqem, takohem, shqyrtoj, pyes, udhëtoj...*
- **Ndajfoljet:** *tani, atëherë, gjithmonë, kurrë, këtu, atje, andej, kënde, pak, shumë, guximshëm, fort, dyfish, mjaftueshëm, trefish*
- **Pasthirrma:** *Ej!, Hej!, Ah!, Oj! Aaah, Eh!, Eee!, Eh!, Uau!, Ha! Tu!, Oof!, Oh! Obobo!*
- **Lidhëzat:** *dhe, edhe, as...as, , por, mirëpo, kurse, megjithatë, ose...ose, prandaj, që, se, kur, sapo, sepse, pse, nëse, për shkak se*
- **Fjalët dhe shprehjet pyetëse:** *a, çfarë, kush, ku, kur, sa, pse, si, në çfarë mënyre...*

- Përdor në mënyrë të duhur emrat dhe mbiemrat kur kërkon, pyet ose përgjigjet, duke respektuar kategoritë e gjinisë, të numrit dhe të shquarsisë.
- Përdor numrat deri në 1000 në komunikim të drejtpërdrejtë.
- Dallon kuptimin e foljeve dhe i përdor ato në shembujt e vet.
- Përdor shprehje dhe fjalë të sapomësuar, në komunikimin e përditshëm.

• Fjalët dhe shprehjet pyetëse: <i>a; çfarë, kush; ku, kur, sa, pse, si, çka, në çfarë mënyre, sa larg është, sa herë si kaluat, si ju pëlqeu...</i>	
c) Gramatika • Fonetika dhe drejtshqiptimi Shqiptimi i drejtë i bashketingelloreve: <i>q, ç, gj, xh, r, rr, k, g, t, d, th, dh</i> nga sistemi i bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe Ndërrimet fonetike: zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve • Morfologjia Emrat – Rasat e emrit Mbiemrat Kategoria gramatikore e shkallës së mbiemrave Foljet Koha e kryer: <i>kam blerë, kam paguar, kam fituar, kam bashkuar, kam rregulluar; jam veshur, jam larë, jam krehur, jam përshtatur;</i> Koha e ardhme e së shkuarës: <i>do të blija, do të paguaja, do të fitoja, do të bashkoja, do të rregulloja; Do të vishesha, do të lahesha, do të krihesha, do të përshtatesha.</i> Format e pashtjelluara: - Pjesorja: <i>qenë, pasur, blerë, paguar, fituar, marrë, sjellë, dhënë, ngrënë.</i> - Paskajorja: <i>për të qenë, për të pasur, për të blerë, për të paguar, për të fituar, për të marrë, për të sjellë, për të dhënë, për të ngrënë.</i>	• Njeh dhe shpjegon ndërrimet fonetike - zëshmimin dhe shurdhimin e tingujve. • Përdor drejt fjalët në të cilat kanë ndodhur ndërrimet fonetike - zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve. • Jep shembuj të llojeve të ndryshme të emrave dhe funksionin e tyre në një fjali. • Tregon shembuj nga komunikimi i përditshëm të emrave që hyjnë në marrëdhënie të ndryshme me pjesë të tjera të ligjëratës në fjali. • Dallon shkallën krahasore dhe sipërore të mbiemrat. • Dallon dhe jep shembuj me mbiemra të përdorur në shkallë të ndryshme. • Njeh foljet në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme të së shkuarës në fjali dhe në një tekst (të shkurtër). • Njeh dhe dallon format e foljeve në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme të së shkuarës. • Dallon dhe krahason ndërrimet me fojen <i>kam</i> dhe <i>jam</i>. • Njeh trajtat e formave të pashtjelluara të foljes në një fjali. • Krahason trajtat e formave të pashtjelluara të foljes. • Interpretin kuptimin e trajtave të formave të pashtjelluara të foljes në një fjali. • Dallon trajtat e formave të pashtjelluara të foljes. • Ndërton shembuj duke përdorur trajtat e formave të pashtjelluara të foljes. • Njeh dhe jep shembuj të përcaktorit. • Njeh dhe ndërton shembuj fjalish të përbëra.

- Përcjellorja: <i>duke qenë, duke pasur, duke blerë, duke paguar, duke fituar, duke marrë, duke sjellë, duke dhënë, duke ngrënë.</i> Trajtat e shkurta të përemrave vetorë: <i>(mua) më, (ty) të, (atë) e, (ne) na, (ju) ju, (ata/ato) i</i> – në funksion të kundrinorit të drejtë <i>(mua) më, (ty) të, (atij/asaj) i, (neve) na, (juve) ju, (atyre) u</i> – në funksion të kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë <i>më tregoi (mua), të takoi (ty), i tha (atij), na tregoi (neve), u blenë (atyre), i vizituan (ato)</i> Bashkimi i trajtave të shkurtra: <i>ia, ua, m'i, t'i, ta, ma, t'u, t'ju, t'ia...</i> Sintaksa Përcaktori Fjalë e përbërë Llojet e fjalëve të përbëra me bashkërenditje (shtuese, veçuese, kundërshtore dhe përmbyllëse)	- Ndërton dhe tregon shembuj të fjalëve të përbëra me bashkërenditje. - Krahason thënie të shprehura me një fjali të thjeshtë dhe me një fjali të përbërë. - Përdor drejt fjalitë e përbëra me bashkërenditje.
ç) Të lexuarit dhe të shkruarit - Të dëgjuarit dhe të lexuarit e teksteve me leksik të përshtatshëm, e dialogëve dhe e fjali me strukturë gramatikore më komplekse - Të dëgjuarit dhe të lexuarit me të kuptuar e fjalëve të reja, e dialogëve dhe e teksteve të reja - Të dëgjuarit dhe të lexuarit dhe të përgjigjurit e pyetjeve që lidhen me dialogët dhe me tekstet - Nxjerrja e përfundimeve nga tekstet dhe të shkruarit e qartë	- Identifikon fjalët e panjohura në një tekst. - Bën pyetje rreth tekstit dhe u përgjigjet pyetjeve të parashtruara. - Lexon dhe komenton atë që është lexuar, në mënyrë të pavarur dhe sipas pyetjeve udhëzuese. - Lexon me shqiptim të drejtë të tingujve, me theksim të drejtë të fjalëve dhe me intonacion të duhur. - Shkruan tekst sipas udhëzimeve ose pyetjeve të përcaktuara. - Tregon ngjarje duke përdorur trajtat e foljeve të kohës së kryer. - Përshkruan duke përdorur formë të ndryshme të të shprehurit me shkrim. - Vazhdon një tekst të filluar. (Ri)tregon duke përdorur foljet në të ardhmen e së shkuarës.

• Të shkruarit e tekstit duke përdorur fjalë dhe shprehje të sakta nga ana gramatikore dhe semantike • Të shkruarit (në mënyrë të pavarur/ diktim kreativ)	
d) Tema për diskutim • Ekskursion dhe vizita e fshatrave/qyteteve/objekteve/lokaleve Fakte të reja të mësuara për vendet / lokacionet / bukuritë e rralla natyrore të vizituara <i>Deri tani e dija/nuk e dija se...</i> <i>Deri më tani nuk e kam ditur se Xhamia Larme është në Tetovë.</i> <i>Nuk e dija se emri i teqesë është “Arabati Baba”.</i> Ngjarje dhe përvoja gjatë udhëtimeve brenda dhe jashtë vendit tonë të mrekullueshëm -Maqedonisë së Veriut <i>Udhëtimi për në Mavrovë ishte interesant dhe emocionues.</i> <i>Dua të vizitoj qytetin e Kërçovës...</i> <i>Në Strugë takova Fatimen, shoqen time më të mirë. Që atëherë, çdo verë kaloj dhjetë ditë në Strugë.</i>	• Numëron karakteristikat e shoqërimit dhe socializimit gjatë realizimit të ekskursioneve. • Tregon përfitimet nga kontaktet me bashkëmoshatarët dhe rëndësinë e ekskursioneve shkollore. • Prezanton dallimet e kulturave dhe mënyrën e jetesës së njerëzve në pjesë të ndryshme të vendit. • Përfshihet në bisedë dhe zhvillon dialog për të fituar përvojë për pavarësi dhe për kujdes për veten. • Prezanton ngjarje nga ekskursionet e përbashkëta – vizita vendesh dhe përjetime.
Shembuj të aktiviteteve: <i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i> • Nxënësve u jepen karta ku paraqitet natyra, pylli, lumenjtë, liqenet dhe u jepet detyrë të shkruajnë fjali për atë që kanë parë. Ajo që është shkruar shpërndahet dhe diskutohen fjalët e përdorura dhe saktësia e tyre gramatikore në kontekstin e përdorur. • Nxënësit ndahen në grupe dhe u jepet një fletë mësimore me tekst/dialog dramatik: <i>Çfarë ka për darkë?</i> Agimi: <i>Përrshëndetje Anila. A mund të vijë Hasani me ne?</i> Anila: <i>Po, nuk ka problem.</i> Agimi: <i>Çfarë kemi për darkë?</i> Mira: <i>Po bëj specatë të mbushura.</i> Agimi: <i>Specatë të mbushura? Duhet të bësh diçka tjetër.</i> Hasani nuk është shqiptar. Nuk i pëlqejnë gatimet tradicionale shqiptare. Anila: <i>Agim, nga e di ti?</i>	

Si mund të mos haj specat? A ha ai sallatë? Unë gjithashtu bëj një sallatë me domate, tranguj dhe specat. Agimi: Specat janë djegës apo jo djegës? Anila: Ata janë jo djegës. Kemi edhe bukë dhe akullore për ëmbëlsirë. Agimi: Pse nuk hamë diçka normale? Hamburger apo pica? Dhe për pije, a ka Coca-Cola? Anila: Për darkë, Marko, pi gjithmonë qumësht. Agimi: Mirë, mirë. Dhe a mund unë të ha darkë në shtëpinë e tij? Në fletën e punës ka pyetje: Çfarë kërkon Agimi për darkë? A mendoni se Hasanit i pëlqejnë specat e mbushur? Çfarë nuk i pëlqen Agimit për darkë? Ku dëshiron të darkojë Agimi? Çfarë dëshiron të pijë Agimi? Çfarë lloj sallate bën Anila? Secili grup paraqet përgjigjet dhe paraqet zakonet e tij për një mënyrë jetese të shëndetshme.

- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me fjali të dhëna *Dua / Nuk dua*; Kanë për detyrë që të përgjigjen nëse janë dakord sipas pohimit të dhënë: Unë _____ të ha musaka, sepse më bën mire. Unë _____ të pi Coca-Cola, sepse është shumë e dëmshme. Unë _____ të shëtis në natyrë, sepse kjo më çlodh.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepet detyra të intervistojnë shokun e klasës, ta përshkruajnë dhe të thonë se cili është sporti i tij i preferuar.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepen letra me lloje të sporteve. Më pas duhet të bien dakord se në me cilin sport ka dëshirë shoku në çift dhe të thonë një sportist të famshëm nga sporti që ka zgjedhur.
- Nxënësit shikojnë video të shkurtra të sporteve të ndryshme dhe situatave sportive ku ka pasur situata fer dhe jo fer. Nxënësit përshkruajnë dhe japin mendimin e tyre për situatat që kanë parë.
- Punë në çifte. Nxënësve u jepet një fletë mësimore me pyetje me temën: *Sa mirë i njihni miqtë tuaj?* a) *A luan ndonjë shok/vëlla/motër futboll? Në cilin stadium luan? Cilat sporte të tjera janë të njohura në qytetin tuaj? A shkoni në gara?* b) *A mund t'i luash: tenis/volejboll dhe ku? Çfarë lloj sporti është tenisi dhe çfarë lloj është volejboli? (ekipor/individual)* c) *Ku mund të notosh në ambient të mbyllur dhe ku në të hapur?* d) *Ku është vendi më i afërt ku mund të bëni ski/alpinizëm?* e) *Ku mund të praktikoni fitnes? Cili shok ushtron fitnesin? Ku mund të vraponi për rekreacion?* Dhe pastaj zhvillohet një diskutim mes nxënësve rreth asaj se cili është sporti më i mirë.
- Nxënësve u jepet detyra të bëjnë hulumtime se çfarë sportesh ka në RMV dhe cilët janë lojtarët më të famshëm. Pastaj atyre u jepet një temë për diskutim/bisedë: *Sa e njihni skenën sportive në Maqedoni? / E dija se... /mësova se...*
- Fletë pune me tekst të shkurtër: Gara ishte e tmerrshme. Ushtrim për të lexuarit me të kuptuar dhe për fjalë të reja. Në fletën mësimore nxënësit duhet të lexojnë dhe të kontrollojnë kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të mëposhtme: *fushë futboll, ekip futboll, tifozë, stadium, trajner, aksident, fiton një ndeshje, humb një ndeshje*. Më pas, në një diskutim të përbashkët, vërtetohet korrektësia e asaj që u kuptua.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me titullin: *“Legjenda e Stadiumit të Ri” - Përshëndetje. Emri im është Dritan. Unë kam një vëlla më të madh. Ai është futbollist. Stërvitet në klubin sportiv “Fitorja”. Meqenëse jetojmë në një qytet të vogël të quajtur Nihao, klubi kishte një fushë të vogël, stadiumin tonë të vogël. Stadiumi “Fitorja” ndodhej pranë spitalit. Dhe rreth stadiumit kishte disa shtëpi të vogla. Drejtuesit e “Fitores” kanë dashur të ndërtojnë një stadium të ri. Në anën e majtë të stadiumit kishte një shtëpi të vogël, pothuajse të pavërejtur. Në të jetonte një plak. Të gjithë kishin frikë prej tij. Erdhi dita kur duhej të fillonin ndërtimin e stadiumit të ri. Ata shkatërruan*

të gjitha ndërtesat përreth. Por ajo shtëpi e vogël mbeti si një dhëmb. Kur burri vdiq, ata donin të prishnin shtëpinë. Por mjeshtrit brenda gjetën një fletë letre ku shkruhej: "Nëse dikush prish shtëpinë dhe ndërton diçka tjetër në këtë vend, nuk do ta shohë kurrë dritën e saj". Ata i thanë shefave të tyre, por askush nuk e mori seriozisht. Ata e prishën shtëpinë dhe e ndërtuan stadiumin pas disa muajsh. Ekipi i futbollit mezi po e priste stadiumin e ri. Tifozët janë gëzuar në stadiumin e ri. Qyteti i gëzohej stadiumit të ri. Ka ardhur koha për ndeshjen e parë. Për herë të parë "Fitorja" humbi në fushën e vet. Kështu ka ndodhur edhe me të gjitha ndeshjet e tjera. "Fitorja" nuk ishte ajo që ishte. Tifozët nuk ishin më në tribuna. Dhe askush nuk donte të blinte një ekip të tillë. Më pas nxënësit u përgjigjen e pyetjeve: Ku jeton Dritani? , Çfarë ka Dritani? , Çfarë sporti bën vëllai i Dritanit? Cili është emri i klubit të futbollit? Cili është emri i stadiumit?

- Nxënësit dëgjojnë një tekst të lexuar nga mësimdhënësi/ja ose një tekst të incizuar. Për detyrë kanë që në fletë pune të plotësojnë vendet e zbrazura në fjalitë e dhëna lidhur me tekstin e dëgjuar:
 - a) _____ do shkojmë në kinema sonte? Jo me vjen keq. Unë _____ vij, sepse _____ shkruaj detyrat e shtëpisë.
 - b) _____ do shkojmë të shohim edhe një film sonte? Jo faleminderit. Në mbrëmje, ka futboll në TV dhe unë _____ shikoj.
 - c) _____ do shkojmë në kinema sonte? - Po, në rregull. – _____ shkojmë së pari për të pirë nga një lëng. - Në rregull _____ laj flokët. Por mund të të pres para Dajmond-it rreth orës 18:30.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepet për detyrë të krijojnë aktivitete të lira shkollore për mbrojtjen e natyrës. Më pas secili çift paraqet aktivitetin e vet dhe për detyrë ka të zgjedhë aktivitetin më të mirë. Në fund gjithë klasa në një periudhë të caktuar kohore e realizon aktivitetin e zgjedhur dhe bën një prezantim të shkurtë me titullin *Para dhe pas* (si ishte natyra para aktivitetit dhe si është pas).
- Nxënësit ndjekin një prezantim nga i cili duhet të zgjedhin një instrument muzikor dhe një sport. Pastaj ata duhet të shpjegojnë pse e zgjedhën atë dhe të paraqesin hobin e tyre.
- Nxënësve u jepet detyrë të prezantojnë hobin e tyre me një prezantim në PowerPoint.
- Nxënësve u jepet një detyrë shtëpie për të hulumtuar artistë të famshëm nga vendi dhe nga vendet fqinje dhe për të bërë një prezantim rreth saj. Më pas në orën tjetër prezantojnë hulumtimin.
- Nxënësit ndahen në grupe të vogla dhe për detyrë kanë të bëjnë hulumtim rreth një koncerti që është mbajtur për qëllime humanitare. Këtë hulumtim duhet ta prezantojnë para të gjithëve.
- Nxënësit ndjekin prezantimin që përbëhet nga fragmente të festivaleve të famshme të filmit dhe të muzikës dhe të çmimeve që ndahen. Dhe më pas zhvillohet një diskutim për materialin e ndjekur dhe për autorët / interpretuesit / regjisorët dhe aktorët e tyre të preferuar.

- Loja *Në rolin e* Nxënësit tërheqin nga një zarf me fotografi të një artisti të famshëm. Nxënësi që ka tërhequr zarfin, duhet ta përshkruajë artistin me fjalët e tij, kurse të tjerët duhet të qëllojnë për cilin artist bëhet fjalë.
- Nxënësve u jepet fletë mësimore me qëllim që ta plotësojnë me emra dhe mbiemra përkatës, për shembull: Dje me miqtë _____ ishim në qendrën tregtare _____. Aty kishte shumë dyqane _____. Dëshim të blemë bluza _____ dhe xhinse _____. Xhinset ishin shumë _____, prandaj blemë vetëm një palë. Në qendrën _____ kishte edhe shumë _____ për aksesore mode. Mua më pëlqyen kuletat ngjyrë _____. Kishte edhe _____ të reja të atleteve Xhordan. Por, mua më duheshin këpucë _____.
- Nxënësve u jepet fletë pune për të plotësuar vendet e zbrazëta në fjali. Fjalët për plotësim (*e/i/të/argjendtë, i,e/të/bukur/a, e/i/të mrekullueshëm/me, e/i/të çmuar*):
Ky është një gjerdan _____. Në gjerdanin ka një varëse. Në të ka shumë diamantë.
Kjo është një unazë _____. Ajo është nga Franca. Në të ka pesë diamantë.
Ky rrip _____ përmban shumë gurë _____, është shumë i vjetër dhe është nga Amerika.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me temë: *Dhuratë për ditëlindje*. Ata duhet t'i plotësojnë fjalitë me mbiemrat dhe emrat e duhur (dorë / muzikë / i, e re / futboll / top / prindër /shokë / bluzë / dres/ foto aparat / motor / çantë shpine / ngjyra të ndryshme e kuqe/e verdhë/ e gjelbër / këpucë / fustan / xhinse
1. Epo, unë mora një orë _____ nga nëna dhe babai im, dhe gjithashtu mora një CD _____ nga vëllai im.
2. Unë mora një stilolaps _____ nga _____.
3. Unë mora top _____ dhe _____ me topin e futbollit të pikturuar në të.
4. Unë mora _____ dhe _____.
5. Unë mora një telefon _____.
6. Unë mora _____ të ri. Ai ka rrathë të verdhë, të kuq dhe portokalli. Mora edhe _____ të bardhë.
- Nxënësit në bisedë i tregojnë dhe i përshkruajnë monumnetet në vendbanimin e tyre. (shtëpi memoriale, përmendore, objekte arkeologjike, objekte fetare...)
- Nxënësit shikojnë emisione për objektet fetare (kisha/xhami), pastaj ndahen në dy grupe. Të dy grupet përmes vizatimeve ilustrojnë objektet fetare dhe i përshkruajnë ato gojarisht. Mësimdhënësi/ja jep informatë kthyesë për suksesin e detyrës dhe udhëzime për përmirësim eventuale.
- Nxënësit, në çifte, marrin pjesë në aktivitetin -lojë "Qëllaje objektin dhe përshkruaje atë". Çdo nxënës duhet të imagjinojë një objekt që gjendet në klasë. Më pas, çdo nxënës në një fletë duhet të shkruajë tre mbiemra që e përshkruajnë objektin e imagjinuar (për shembull, nëse nxënësi e ka imagjinuar objektin "derë", mund t'i shkruajë mbiemrat: e bukur, e madhe, e vogël. Kështu duhet të veprojnë edhe për fjalë të tjera të imagjinuara, të cilave mund t'ua shtojnë mbiemrat: *i, e mirë, i, e dashur, i, e respektuar, argëtues, shkencor, bashkëkohor,*

modern, i dobishëm, i padobishëm, tradicional, (i pa)njohur, i vetëm, i vetmuar, i thatë, i njomë, i saktë, i dashuruar, i freskët, i gabuar, i yndyrshëm, i kthejllët, i turbullt, individual, kolektiv, lojal, besnik, vendas, i huaj). Më pas nxënësit ndërrojnë fletët dhe secili prej tyre, në bazë të mbiemrave të shkruar, duhet ta qëllojë objektin e imagjinar nga shoku. Çifti merr një pikë, kur të dy nxënësit e çiftit do ta qëllojnë fjalën e shokut dhe do të tregojë kategoritë gramatikore të mbiemrave të përdorur për të përshkruar fjalën/emrin.

- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me një tekst të shkurtër që lidhet me disa nga përmbajtjet e lëndëve të tjera. Ata i gjejnë emrat në tekst dhe më pas për to mendojnë mbiemra, me të cilët do të formojnë ndërtime të sakta kuptimore dhe gramatikore (emër dhe mbiemër/mbiemra).
- Nxënësve u jepet detyrë të krijojnë një dialog për blerjen dhe shitjen e gjërave të caktuara, duke u kushtuar vëmendje numrave deri në 1000 dhe mënyrës se si shkruhen këto numra. Nxënësit duhet të kenë kujdes gjatë përdorimit të diatezave të foljeve të mëposhtme: *blej/blihet, shes/shitet, liroj/lirohet, zgjedh/zgjidhet....*
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore ku duhet të rrethojnë foljen e saktë: *them/kam thënë, shoh/kam parë, flas/kam folur....* Shembull: *Unë moti them/kam thënë se kjo punë nuk bëhet. Merti e sheh/e ka parë atë film qysh vitin e kaluar etj.*
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepen fletë mësimore ku janë shkruar pesë folje në mënyrën dëftore në kohën e tashme. Për detyrë kanë t'i kthejnë këto folje në kohën e kryer p.sh.: *punoj- kam punuar, hapim-kemi hapur*. Më pas, pesë folje që janë në kohën e pakryer duhet t'i kthejnë në kohën e ardhme të së shkuarës, p.sh.: *këndoja – do të këndoja, dëgjonim – do të dëgjonim*. Punën e prezantojnë para gjithë klasës. Në fund u jepen fletë mësimore me fjali, në të cilat përdoren foljet: *vrapo, luaj, flas dhe shoh*. Çdo çift ka për detyrë të përcaktojë kategoritë gramatikore të foljeve të dhëna. Më pas prezantohet puna dhe komentohen kategoritë gramatikore të foljeve të përdorura.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepen karta me fjali me renditje të gabuar të fjalëve. Ata duhet të ndërtojnë fjalinë me rend të drejtë të fjalëve. Shembull: *Dje libër dyqan në një bleva. (Dje bleva një libër në dyqan); Asnjëherë ushqim dua nuk të djegës ha (Asnjëherë nuk dua të ha ushqim djegës)*
- Nxënësve u jepet një tekst i shkurtër. Ata duhet t'i nxjerrin pasthirrat në fletoren e shkollës. Më pas, me pasthirrat e nxjerra duhet të ndërtojnë fjali.
- Nxënësve u jepen fjali të thjeshta. Ata duhet t'i lidhin ato me lidhëzat përkatëse: dhe, prandaj, as, por, por, megjithatë, ose...ose, kur, qëkur, pasiçë, sapo, sepse, pse, me qenë se, nëse, që. Shembull: *Në dyqan bleva bukë_____ qumësht. _____ do të ha _____ nuk do të ha.*
- Nxënësit ndahen në çifte dhe atyre u jepen fjali pohore. Për detyrë kanë të parashtrojnë pyetje të sakta duke përdorur fjalë dhe shprehje pyetëse: *a, nëse; çfarë kush; ku, kur, sa, pse, si, çfarë, në çfarë mënyre, sa larg, sa herë, si e keni kaluar kohën tuaj, si ju pëlqeu...* Shembull: *Mua më pëlqeu filmi. _____ ju pëlqeu filmi?*

- Nxënësve ju jepen fletë mësimore me fjalë të shkruara saktë dhe gabim lidhur me shurdhimin e tingujve. Nxënësit kanë për detyrë t'i zbulojnë gabimet.
- Në tabelë, nxënësve në një kolonë u shkruhen mbiemra të ndryshëm. Pranë kësaj kolone shtohen edhe dy kolona të tjera për shkallën krahasore dhe atë sipërore. Nxënësit duhet t'i gjejnë mbiemrat që e kanë kategorinë gramatikore të shkallës dhe në kolonat përkatëse t'i shkruajnë format e duhura. Më pas u jepet detyrë që, me këto mbiemra, të shkruajnë fjali, në të cilat do të përdorin shkallën krahasore dhe atë sipërore.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çifteve u jepen zarfe dhe udhëzime për të përcaktuar kohën e saktë të foljes në mënyrë që të përcaktojnë/shkruajnë një veprim që shënon veprim të papërfunduar dhe një veprim të përfunduar: *blija – kam blerë, paguaja – kam paguar, anëtarësoja – kam anëtarësuar, planifikoja – kam planifikuar* etj.
- Nxënësve u jepet një tekst që përmban mjaft folje pavetore. Për detyrë kanë t'i gjejnë foljet pavetore dhe të diskutojnë përdorimin dhe karakteristikat e këtyre foljeve.
- Nënësit punojnë në çifte duke përdorur teknikën *Një minuë punë*. Ata kanë për detyrë të përdorin format e pashtjelluara të foljes dhe ta diskutojnë funksionin e tyre. (p.sh.: *Punuar/Pa punuar/Për të punuar/Duke punuar*.)
- Nxënësve u jepen folje dhe shprehje foljore (blej, bëj pazar, riparoj, gjej, porosit, marr me qira, etj.) dhe u jepet detyrë t'i kthejnë ato në emra prejfoljorë që do t'i përdorin në fjali. Më pas ata i lexojnë fjalitë para të gjithëve në klasë.
- Nxënësve u jepet detyrë të tregojnë një ngjarje/ndodhi duke përdorur foljet në formën veprore dhe joveprore. Për punën e bërë ata marrin informatë kthyesë nga shokët e tyre të klasës.
- Nxënësve u jepen fjali të shkurtra në kohën e tashme dhe kanë për detyrë kohën e foljes ta kthejnë në të kryerën apo në kohën e ardhme të së shkuarës.
- Nxënësve u jepet detyrë të bëjnë fjali me foljen në kohën e kryer (p.sh.: *kam bërëtitur/kam vishur/kam larë*) dhe u jepet detyrë që këto fjali t'i kthejnë në fjali mohore dhe pyetëse.
- Nxënësve u jepen ilustrime të ndryshme, të cilat do t'i ndihmojnë ata të shkruajnë fjali ku do t'i përdorin foljet *kam* dhe *jam*. Nxënësit udhëzohen që t'i përdorin ato në vetë, në numër dhe në kohë të ndryshme. (p.sh. *Ky njeri në të shkuarën ka pasur makinë të shtrenjtë dhe luksoze, tani ka vetëm biçikletë të cilën e përdor për rekreim*.)
- Nxënësit formojnë një rreth. Çdo nxënësi i jepet një fletë ngjitëse, të cilën ai/ajo e ngjit në shpinën e shokut/shoqes së klasës. Në këtë fletë duhet të shkruajë disa mbiemra pozitivë për të. Pastaj këto mbiemra i lexojnë me zë.
- Nxënësve u jepen fletë ku janë shënuar disa fjali të thjeshta. Më pas u jepet detyrë për të shkruar një fjali të përbërë.

- Nxënësve u jepet një tekst me përmbajtje të njëjtë. Ata ndahen në dy grupe. Teksti me përmbajtje të njëjtë te njëri grup është shkruar vetëm me fjali të thjeshta, kurse teksti i grupit tjetër është shkruar me fjali të përbëra. Nxënësit duhet të shohin dallimin mes fjalive dhe të përcaktojnë se cili tekst është më i kuptueshëm për ta. Më pas nxënësve të grupit të parë u jepet për detyrë ta shkruajnë tekstin me fjali të përbëra, kurse nxënësve të grupit të dytë u jepet për detyrë që tekstin ta shkruajnë me fjali të thjeshta. Puna e bërë prezantohet para klasës dhe krahasohet saktësia.
- Nxënësve u jepet detyrë të lidhin fjalitë e dhëna me lidhëza të caktuara (*dhe; edhe; as; jo vetëm që...,por edhe; prada; andaj*).
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore, në të cilën jepet për detyrë të lidhen fjalitë me lidhëzat përkatëse për fjalitë kundërshtore (*po, por, kurse, ndërsa, megjithatë*).
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore, në të cilën ata duhet t'i vendosin lidhëzat adekuate dhe të përcaktojnë se për çfarë lloji të fjalisë së përbërë me bashkërenditje bëhet fjalë.
- Nxënësve u jepet një link i krijuar në wordwall.net. Në link-un e dhënë paraqitet loja *Hape kutinë*. Në çdo kuti ka lloje të ndryshme fjalie dhe nxënësit duhet ta qëllojnë llojin e fjalisë.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me përralla popullore, p.sh.: *Nasradini ; E bukura e dheut*. Për detyrë kanë t'i nxjerrin fjalët e panjohura dhe ta diskutojnë mesazhin e përrallës.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me përshkrimin e enterierit (pjesës së brendshme) të një shtëpie dhe me përshkrimin e eksterierit (pjesës së jashtme) të një shtëpie. Ata kanë për detyrë të bëjnë përshkrimin e vendit të tyre të preferuar .
- Nxënësve u jepen karta ku paraqitet natyra. U jepet detyrë të bëjnë një tregim / përshkrim të shkurtër për një ngjarje që mund të ndodhë.
- Dy nxënësve u jepet një dialog i shkurtër, të cilin e interpretojnë para klasës. Nxënësit shkruajnë atë që dëgjojnë, duke përdorur rregullat drejtshkrimore për të shënuar ligjëratën e drejtë. Në tabelën e zgjuar (smart) ose në fletën e punës është shënuar forma e dialogut dhe mësimdhënësi/ja bashkë me nxënësit e ushtrojnë drejtshkrimin.
- Nxënësit, të ndarë në 5 grupe, tërheqin një kartë nga kompleti i kartave, në të cilat janë shkruar (nga një në secilën kartë): RACA (*të bardhët, zezakët dhe të tjerët*), GJINIA (*djalë, vajzë, grua, burrë*), PROFESIONI (*policë, mjekë, mësimdhënësi e të tjerë*), MOSHA (*të moshuar, të rinj, adoleshentë*), ANËTARËT E FAMILJES (*bija, biri, nëna, babai, gjyshja, gjyshi*). Në një fletë të madhe letre, secili grup duhet të përshkruajë (me fjalë dhe me vizatim) se si njerëzit e kartës që kanë tërhequr, janë paraqitur në media (në filma, seriale, reklama) - si duken, si sillen dhe çfarë cilësish kanë. Në një fletë tjetër, ata duhet të shkruajnë edhe shembuj nga mediat, në të cilat e kanë parë këtë (cili film, serial, reklamë). Pas përfundimit të punës, secili grup (një nga një) i var në mur fletët e veta me përshkrimet dhe shembujt dhe ua prezanton punën të tjerëve. Pas çdo prezantimi, nxënësit e grupeve të tjera plotësojnë me shembujt e tyre dhe së bashku konstatohet se çfarë përshkrimi dominon në media. Mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë të gjitha përshkrimet e treguara që përputhen me stereotipet

e zakonshme për grupet (p.sh.: *Zezakët janë kriminelë, shesin drogë... Gjyshet janë të kujdesshme, bëjnë byrek, nuk përdorin grim... Djemtë janë të guximshëm, të fortë, nuk qajnë*). Diskutimi përfundimtar është se të gjithë duhet të punojnë me veten e tyre dhe me të tjerët së bashku në klasë për të kapërcyer stereotipet.

- Nxënësve u jepen karta me personazhe dhe me një shpjegim të shkurtër rreth një ngjarjeje. Ata duhet të bëjnë një dialog.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një tekst, e lexojnë dhe prej tij nxjerrin dhjetë fjalë sipas zgjedhjes së tyre. Këto fjalë i përdorin për të shkruar një tregim të vetin.
- Nxënësve u jepet një fletë mësimore me një tregim të dhënë dhe nxënësit kanë për detyrë të përcaktojnë pjesën hyrëse, pjesën kryesore dhe përfundimin e tregimit. Punën individuale e prezantojnë para të gjithëve në klasë.
- Ushtrime për pasurimin e fjalorit: *Qëlloje se çfarë do të thotë*. Nxënësve u jepet një tekst i shkurtër, në të cilin ka fjalë të panjohura për ta. Ata duhet ta gjejnë dhe ta tregojnë kuptimin e fjalës nga konteksti në fjali. Fjalët shkruhen në tabelë dhe diskutohen.
- Nxënësve u jepen fletë pune me një tekst, në fjalitë e të cilit ka vende të zbrazura për t'u plotësuar. Ata kanë për detyrë t'i plotësojnë këto vende të zbrazura. Nën tekstin ofrohen disa përgjigje si alternativa, në varësi të asaj që mungon në fjali. Për shembull ka parafjalë, lidhëza, folje, mbiemra.
- Ushtrim për ritregim. Në tavolinën e mësimdhënësit/es vendosen kartona të verdhë në formë tullash, në të cilat janë shkruar pyetjet: *Si fillon tregimi?, Cilët janë personazhet?, A ka ndonjë problem?, Çfarë problemi has personazhi?, Kush është personazhi negativ në tregimin?* etj. Me secilën kartë, nxënësit inkurajohen t'u përgjigjen pyetjeve për tekstin e lexuar në mënyrë që të ushtrohet të folurit e gjuhës.
- Pas leximit të një teksti, mësimdhënësi/ja bën një kuiz me pyetje që lidhen me tekstin e lexuar. Nxënësve u jepet detyrë t'u përgjigjen pyetjeve.
- *Parashikimi* – (me stuhi idesh sipas titullit të një teksti/tregimi të caktuar) nxënësit parashikojnë se çfarë mund të ndodhë në tregimin. Më pas lexohet dhe përcaktohet përgjigja e saktë.
- Intervistë: Çdo nxënësi i jepet një kartë (ka dy lloje kartash: njëri gazetar dhe parashtrohet pyetje, tjetri - një person i famshëm, i cili u përgjigjet pyetjeve).
- Në një prezantim të përgatitur paraprakisht, nxënësit ndjekin sllajde me foto. Në fletore duhet të shënojnë emrin e asaj që shohin (ngjarje historike, tubime kulturore, kisha, manastire, xhami, parti politike). Më pas shembujt shkruhen në dërrasë dhe diskutohet se si janë shkruar. Pas diskutimit paraqiten sllajdet me emrat e shkruar saktë.
- Nxënësit punojnë të mënyrë të pavarur. U jepet një tekst, të cilit i mungojnë shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpyetja, dy pikat, tri pikat, pikëçuditja, apostrofi, thonjëzat. Ata duhet t'i vendosin ato në vendin e duhur. Në fund të aktivitetit nxënësve u jepet një fletë pune ku shenjat e pikësimit janë përdorur drejt dhe secili nxënës kontrollon saktësinë e shenjave të përdorura.

Tema: **Komunikimet, lidhjet dhe njohja e ngjashmërive dhe dallimeve**

Gjithsej: 14 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të krijojë fjali me fjalor të përshtatshëm në të cilat shpjegon shkurt se çka planifikon në lidhje me veten dhe me zhvillimin, mendimin dhe marrëdhënien e vet me të tjetrët;
2. të ndërtojë fjali në gjuhën shqipe: të thjeshta dhe të përbëra;
3. të marrë pjesë në biseda në të cilat e shpreh mendimin e vet duke përdorur trajtat e përshtatshme të emrave, mbiemrave, përemrave dhe foljeve;
4. të përdorë shprehje dhe fjali me trajtat e duhura të foljeve në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme të së shkuarës;
5. të marrë pjesë dhe të zhvillojë biseda në tema të ndryshme.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet)

a) Modelet e komunikimit

- **Planifikoj dhe organizohem**

Sot do t'i kryej detyrat e mëposhtme... Ky është plani im: Çfarë do të bëj së pari? Çfarë do të bëj më pas? Ku do të mësoj? Kur të bëj pushim (pauzë)? Kur do të mbaroj me punë? Do ta diskutoj planin me:...

Do të jem i/e kënaqur nëse arrij të:...

Për të përmirësuar mësimin, do të kërkoj ndihmë nga Këta nxënës: ...

Kur të lodhem, do të rimbush energjinë time me...

Kur të mbaroj, do të luaj playstation.

Kur të mbaroj, mund të shoh video të shkurtra.

Këtë verë do të shkoj në kurs për zhytje.

Në vjeshtë do të antëtarësohem në një klub alpinistësh.

- **Unë mendoj - ti mendon**

Standardet për vlerësim:

- Përdor drejt trajtat e foljeve në fjali (Kur do të Atëherë do të...), me të cilat shpreh/planifikon veprime në të ardhmen.
- Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve duke përdorur trajtat e foljeve të kohës së ardhme.
- Përpilon shprehje me të cilat shpjegon cili është qëndrimi i vet për një temë të caktuar.
- Përpilon pyetje dhe përgjigje duke përdorur folje në kohën e tashme dhe emra dhe mbiemra prejfoljorë duke shprehur mendime të cilat i referohen punëve nga jeta e tij/saj.
- Shpjegon me fjalët e tij/saj se për çfarë i shërben interneti dhe rrjetet sociale dhe cila është më e mirë sipas mendimit të tij/ saj.
- Përdor fjalor të ri duke komentuar qëndrimet e shokëve të klasës për komunikimin e drejtpërdrejtë dhe atij *online*.
- Diskuton dhe jep sugjerime për tejkalimin e konfliktit duke bërë dallimin e kohës së tashme dhe të ardhme të foljeve, në thëniet e tij.
- Përdor fjalor të ri të përshtatshëm për temën.

Si t'i dëgjojmë dhe kuptojmë mendimet dhe qëndrimet e të tjerëve?

Qëndrimet ndaj mësimi/lëndëve, sportit, letërsisë, teatrit.

Unë mendoj se mësimi është...

Sporti është...

Unë mendoj se nxënësit tanë të klasës së tetë do t'i fitojnë nxënësit e klasës së nëntë në ndeshjen e basketbollit nesër.

Unë mendoj se nxënësit e klasës së nëntë do të fitojnë.

Komunikimi i drejtpërdrejtë ose online – unë mendoj se është më i mirë komunikimi... sepse ...

Interneti është një vend ku...

Mendoj se internet nuk është vendi ku...

- **Zgjidhja e konflikteve**

Si t'i shprehim ndjenjat tona

A jeni dakord me thënien: Jemi të fortë kur pranojmë ndihmë!

Si të ballafaqohem/i me problemet?

Çfarë prisni nga një mik i mirë kur keni një problem?

Cilat janë pikat tuaja të forta kur të tjerët kërkojnë ndihmë nga ju?

Cila përgjigje nuk ju pëlqen kur doni të flisni për problemet tuaja?

Si mund t'ju njohin se ju nuk jeni në disponim?

Çfarë mund të bëjnë miqtë për ta bërë më të lehtë bisedën për problemet?

A kërkon ndihmë nga mësuesi/ja? Nga prindi/ët?

A jeni pjesë e konflikteve ku për shkak të diçkaje jeni i/e ndryshëm/e?

Si t'i shmangemi konfliktet në shkollë?

b) Njësitë leksikore Emrat: <i>detyrat, organizimi, plani, puna, detyrimet, interneti, playstationi, videot, tiktok-u, garat, qëndrimi, mendimi</i> Emrat prejfoljorë: <i>planifikimi, argëtimi, organizimi, vrapimi</i> Mbiemrat: <i>vendas, i huaj, i papërshtatshëm, i përshtatshëm</i> Foljet: <i>mendoj, komunikoj, flas, njoftoj, këshilloj, propozoj, pajtohem, nuk pajtohem, përmbahem</i>	• Përdor në mënyrë të duhur njësitë leksikore në thënie dhe në fjali, duke respektuar rregullat gramatikore për përdorimin e emrave, mbiemrave dhe përemrave në kategorinë përkatëse. • Përdor si duhet njësitë leksikore në fjali duke respektuar rregullat gramatikore për përdorimin e foljeve në kohën, vetën dhe numrin e duhur (në të tashmen, në të kryerë dhe në të ardhmen).
c) Gramatika • Përemrat Përemrat pyetës: <i>kush, cili, cila, ç', çfarë, çka.</i> Përemrat e pacaktuar: <i>dikush, askush, asnjëri, diçka, secili.</i> <i>Cila nxënëse do të garojë?</i> <i>Kush tha kështu?</i> <i>Secili thotë diçka.</i> <i>Nuk i besoj asgjë.</i> • Foljet – mënyra habitore • Koha e ardhme <i>Së pari do të shkruaj detyrat e shtëpisë, pastaj do të lexoj lektyrën.</i> <i>Do të bëj një dush dhe do të shkoj në ditëlindje.</i> <i>Javën e ardhshme do të bëjmë test në matematikë.</i> <i>Kush do të zëvendësojë mësuesin e anglishtes të mërkurën e ardhshme?</i> <i>Të organizohemi në fundjavë për vrapim, do të ketë maratonë.</i> • Koha e kryer	• Përdor drejt llojet e përemrave pyetës dhe të pacaktuar. • Përdor drejt foljet në mënyrën habitore. • Parashtron dhe u përgjigjet pyetjeve duke përdorur kohën e ardhme për veprimet që do të ndodhin pas çastit të të ligjërit. • Ndërton fjali duke përdorur foljet që ka mësuar në kohën e ardhme për shprehur planet e veta. • Rrëfen duke përdorur trajta të kohës së kryer të foljeve për veprime dhe ngjarje që kanë ndodhur në të shkuarën. • Përdor në mënyrë të përshtatshme përcaktorin në fjali. • Dallon llojet e ndajfoljeve dhe i përdor ato drejt në komunikimin me shkrim dhe me gojë. • Krijon fjali të thjeshta dhe të përbëra duke përdorur mënyrat dhe trajtat e kohëve të foljeve që kanë mësuar.

<i>Ai ka ndjekur shumë ndeshje.</i> <i>Ne kemi qenë fitues atë ndeshje vetëm dy herë.</i> Format e foljes pavetore - <i>Para shiut bubullonte shumë.</i> <i>Jashtë frynte.</i> • Ndajfoljet (llojet dhe shkallët e ndajfoljeve); <i>nesër, më vonë, pasdite, kudo, diku, më mire, shumë shpejt.</i> • Fjalë – e thjeshtë dhe e përbërë Kryefjala, kallëzuesi, përcaktorët, rrethanorët dhe llojet e rrethanorëve	
ç) Të lexuarit dhe të shkruarit (përmbajtje nga tema: planifikimi, shprehja e mendimeve personale, zgjidhja e konflikteve)	• Lexon dhe kupton tekstet e thjeshta nga shkrimtarët e shquar shqiptarë. • Lexon tekste dhe u përgjigjet pyetjeve rreth tyre. • Parashtron pyetje për tekstin e lexuar. • Shkruan një rezymë të shkurtër për një tekst të shkurtër të lexuar në një temë të dhënë. • Përcakton pjesët e një teksti dhe fjalë kyçe për çdo paragraf.
d) Tema për diskutim • Punë ekipore – (ekip, përkatësia, përpjekja e përbashkët, suksesi, bashkëpunimi dhe komunikimi në punën ekipore)	• Diskuton për rëndësinë e punës ekipore dhe rëndësinë e ekzistimit të ekipit dhe pjesëmarrjes në të. • Jep propozimet e veta për suksesin e ekipit. • Përdor leksik të përshtatshëm për të shprehur dhe për të nxitur bashkëpunim dhe komunikim pozitiv.
Shembuj të aktiviteteve: <i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i> • Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur. Ata bëjnë plan për aktivitetet që i kryejnë gjatë ditës dhe e prezantojnë atë. Përdorin kohën e ardhme në thëniet e tyre. Mësimdhënësi/ja i korrigjon gabimet e mundshme gramatikore dhe leksikore. • Nxënësit në çift thonë fjali me shprehjen <i>kur të</i>: Shembull: <i>Kur të zgjohem do të vij në këndin e lojërave.</i>	

- Nxënësit në grupe nga katër veta bëjnë dialogë, duke i ndryshuar rolet, duke pyetur dhe duke u përgjigjur. *Kush do të vijë nesër në kinema me ne? Së pari do të vijnë Maja, Mira dhe Mironi pastaj do të vijnë Latifja dhe Xhengizi; Çfarë dhurate do të blejmë për ditëlindjen e Besës? Ne do të blejmë një komplet librash, sepse ajo ka dëshirë të lexojë.*
- Nxënësit shkruajnë në fletë temat që duan të diskutojnë (nga ato që i ofron mësuesi në tabelë). Gjatë orës së mësimit diskutohet tema për të cilën ata ishin më të interesuar dhe lihet hapësirë për tema të tjera që do të diskutohen në orët në vijim. Nxënësit në të gjitha diskutimet e tyre përdorin formulime të tilla si: *Unë mendoj se ... sepse ...*
- Nxënësit formojnë fjali sipas shembullit të dhënë: *Organizimi është i rëndësishëm për të gjithë në shkollë.*
- Nxënësve u jepet për detyrë të shkruajnë tri arsye pse parapëlqejnë të përdorin komunikimin e drejtpërdrejtë apo pse atë në rrjete sociale. Secili i paraqet arsyet e veta për zgjedhjen e bërë, para të gjithëve në klasë.
- Nxënësve u jepet një problem konkret në secilin grup: 1. të zgjedhin së bashku se cilin film do ta shohin; 2. të krijojnë një poster për një ndeshje futbolli me një audiencë nga komunitete të ndryshme etnike, në të cilin ata do të bëjnë thirrje për sport dhe tifozeri; 3. të zgjedhin ngjyrën e fanellave për ekipin e tyre, i cili do të shkojë në një garë kuizi. Secili grup i përdor mënyrat e veta të komunikimit, por të gjithë duhet të jenë të sjellshëm me njëri-tjetrin kur duhet të harmonizojnë pikëpamjet e tyre.
- Mësimdhënësi/ja lexon fjali, kurse nxënësit shënojnë me emotikon secilin emocion që e përjetojnë për atë që thuhet në fjali. Kush dëshiron, e shpreh me zë ndjenjën e vet për atë që e ka dëgjuar ose së paku me një fjali e shpjegon emotikonin e vet dhe e vendos te fjalia që i ka lënë më shumë përshtypje.
- Nxënësit i mbushin vendet e zbrazëta me fjalë që duhet të shkruhen në gjininë dhe numrin përkatës.
- Nxënësit, në fjalinë e dhënë, foljen që është në klapa, e vendosin në kohën e duhur. Ata kontrollojnë së bashku pasi që mbarojnë së shkruari.
- Mësimdhënësi/ja tregon shembuj në tabelë duke përdorur lloje të ndryshme të përemrave pyetës dhe të pacaktuar. Nxënësit në çift shkruajnë nga një dialog në të cilin ka të paktën katër replika. Ajo që është shkruar lexohet para të gjithëve në klasë.
- Nxënësve u jepen ilustrime në tabelën inteligjente dhe krijojnë fjali për to në kohën e kryer.
- Nxënësit i shkruajnë planet e tyre për pjesën tjetër të javës duke përdorur kohën e ardhme.
- Nxënësit shkruajnë një tekst të shkurtër për një temë për të cilën do të bien dakord dhe në të cilën përdorin fjali të thjeshta dhe të përbëra, njëkohësisht duke bërë renditjen e drejtë të gjymtyrëve të fjalisë: kryefjala, kallëzuesi, kundrinori, rrethanori. Saktësia kontrollohet së bashku në tabelë me disa shembuj.
- Nxënësit tregojnë mbiemra, përkatësisht përcakrorë për frymorë dhe për sende sipas dëshirës së tyre. Përcaktorët i përdorin në shembuj të përshtatshëm të fjalive.

- Nxënësve u jepet për detyrë që ta përdorin kohën e tashme dhe të ardhme në një fjali të përbërë. Ata e kontrollojnë saktësinë duke e diskutuar me të gjithë në klasë.
- Nxënësit lexojnë një tekst të një autori shqiptar. Ata i nxjerrin fjalët e paqarta për ta dhe i diskutojnë ato në klasë. Më pas bëjnë pyetje rreth asaj që e lexojnë. Të gjithë e thonë pyetjen e tyre me zë të lartë dhe nxënësit e tjerë i përgjigjen pyetjes.
- Nxënësve u jepet një tekst në të cilin ka mjaft fojele në mënyrën habitore. Për detyrë kanë t'i nënvizojnë dhe të tregojnë në cilën vetë dhe në cilin numër janë përdorur.
- Nxënësit lexojnë një tekst që lidhet me një nga temat e komunikimit. Ata bëjnë një përmbledhje të shkurtër dhe e paraqesin atë para gjithë klasës.
- Nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër për një temë të zgjedhur nga mësimdhënësi/ja. Për çdo pjesë/paragraf të veçantë, ata shkruajnë një fjalë që e pasqyron atë paragraf. Në fund e paraqesin atë para gjithë klasës.
- Nxënësve ju jepet një detyrë për të cilën ndahen në grupe. Ata duhet të zgjidhin detyrën në disa nivele: ta lexojnë hartën, të gjejnë objektin e fshehur në klasë sipas hartës, ta përshkruajnë objektin dhe të shkruajnë ku përdoret dhe ku tjetër mund të gjejë përdorim ai objekt. Për shembull, në hartë dhe në klasë ata kërkojnë një tekst shkollor, një komplet të veglave të dorës, një pe me gjilpërë etj. Nxënësit prezantojnë me radhë, sipas asaj kush mbaron i pari.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen nëpërmjet inkuadrimin të të gjithë nxënësve në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personal dhe arsimor, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë nga shkolla). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëlloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi/ja përdor integrimin e temave /përmbajtjeve/ koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlidhin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'u mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi/ja ndjek përvojat, njohuritë dhe aftësitë e mëparshme të nxënësve, përcjell vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informata kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe u japin udhëzime për përmirësim (vlerësim formativ). Për këtë qëllim mësimdhënësi/ja përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet e dhëna me gojë pyetjeve të mësimdhënësit/es ose të nxënësve të tjerë;
- pyetjet e dhëna me gojë dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijes (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- ushtrimet kontrolluese;
- testet e njohurive;
- punimet/realizimet praktike (të shkruarit/krijimit të teksteve sipas kërkesave të ndryshme, ekspozitat, ilustrimet, prezantimet etj.);

Pas përfundimit të secilës teme, nxënësi merr notë me numër për standardet e arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me notën e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative (përmbledhëse) me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2026/2027
Institucioni/bartës i programit	Byroja e Zhvillimit të Arsimit Биро за развој на образованието
Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për arsimin fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe (gjuhë e bashkësive)</i> për klasën VIII. Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“бр. 161/19, 229/20, 3/25 и 74/25) министерката за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик (јазик на заедницата)</i> за VIII одделение.	бр. 12-12084/11 12.9.2025 година Министерка за образование и наука, проф. д-р Весна Јаневска, с.р.